



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

**Nr. 600 Akti**

**Nr. 338 Vendimi  
Tiranë, më 18.1.2021**

**V E N D I M**

Trupi gjykues nr. 4 i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Brunilda Bekteshi</b>	Kryesuese
<b>Valbona Sanxhaktari</b>	Relatore
<b>Genta Tafa (Bungo)</b>	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Elda Faruku, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z.Ferdinando Buatier de Mongeot, në datën 15.1.2021, ora 10:00, zhvilloi në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve) salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Znj. Elona Mihali**, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, e pranishme në seancën dëgjimore.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë** dhe nenet “A”, “Ç”, “D”, “DH”, “E” dhe “Ë” të Aneksit të Kushtetutës;

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2012**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

**TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, komisionere Valbona Sanxhaktari, dëgjoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në seancë dëgjimore, analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

## **I. RRETHANAT E ÇËSHTJES**

1. Znj. Elona Mihali është subjekt i rivlerësimit për shkak të pozicionit të saj si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë. Bazuar në pikën 4 të nenit 4 dhe në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016, si dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, në vijim, ka hedhur shortin në datën 16.7.2020, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit i është nënshtruar procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i sipërcituar.
2. Me vendimin e trupit gjykues, datë 20.7.2020, është vendosur kryesuese komisionere Brunilda Bekteshi dhe është deklaruar lidhur me konfliktin e interesit nga të gjithë anëtarët e trupit gjykues.
3. Subjekti i rivlerësimit është njoftuar për përbërjen e trupit gjykues që do të kryente procesin e rivlerësimit, e cila ka deklaruar se nuk ka konflikt interesi me pjesëtarët e trupit gjykues.
4. Nga relatori janë administruar raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor. Gjatë procesit të rivlerësimit është komunikuar me subjektin e rivlerësimit nëpërmjet adresës elektronike.
5. Në datën 5.1.2021 trupi gjykues vendosi: (i) të përfundojë hetimin kryesisht për subjektin e rivlerësimit, znj. Elona Mihali, bazuar në të tria kriteret e vlerësimit: kriterin e vlerësimit të pasurisë, kriterin e kontrollit të figurës dhe atë të vlerësimit profesional; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit, ta ftojë për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe me nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarit, si dhe afatin brenda të cilit mund t’i ushtrojë këto të drejta dhe të paraqesë parashtrimet e saj.
6. Subjekti i rivlerësimit u njoh me dosjen dhe mori një kopje të saj, fakt të cilin e konfirmoi edhe në seancën dëgjimore. Subjekti i rivlerësimit paraqiti shpjegime lidhur me rezultatet e hetimit të Komisionit.
7. Trupi gjykues, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, ftoi subjektin e rivlerësimit, znj. Elona Mihali, në seancë dëgjimore në datën 15.1.2021, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë.

## **II. SEANCA DËGJIMORE**

8. Seanca dëgjimore u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, në datën 15.1.2021, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier de Mongeot.
9. Në këtë seancë subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht. Ajo paraqiti shpjegime lidhur me rezultatet e hetimit. Në përfundim të seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.
10. Trupi gjykues përfundoi seancën dëgjimore dhe, për rrjedhojë, edhe procesin e rivlerësimit për znj. Elona Mihali në seancën e datës 18.1.2021, në të cilën subjekti ishte e pranishme.

## **III. PROCESI I RIVLERËSIMIT I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

11. Procesi i rivlerësimit, i cili kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Anëtarët e Komisionit hetojnë dhe vlerësojnë të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit. Ata kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo *indicie* në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes.

**12.** Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016 Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja dhe provat e dorëzuara nga subjekti pranë këtij institucioni në “deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*”;
- b) raportin e dorëzuar në Komision nga DSIK-ja, së bashku me dokumentacionin shoqërues;
- c) informacionin e përditësuar lidhur me subjektin e rivlerësimit nga institucionet ligjzbatuese;
- c) raportin e dorëzuar në Komision nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, së bashku me materialin shoqërues;
- ç) dokumentet shkresore nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- d) deklaratimet nga subjekti i rivlerësimit nëpërmjet komunikimit elektronik;
- dh) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit të paraqitura në përfundim të hetimit kryesisht;
- d) denoncimet nga publiku.

## **A. VLERËSIMI I PASURISË**

**13.** Subjekti i deklaratimit ka dorëzuar deklaratën e pasurisë për procesin e rivlerësimit pranë ILDKPKI-së, së bashku me dokumentacionin provues. Kjo deklaratë, në bazë të nenit 33<sup>1</sup> të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, iu nënshtrua hetimit administrativ nga ILDKPKI-ja.

**14.** Në përfundim të hetimit administrativ, bazuar në germën “a”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 86/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja, në raportin e saj, ka konkluduar se:

- a) *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- b) *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- c) *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- d) *nuk ka kryer deklaratim të rremë;*
- e) *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

**15.** Megjithëse sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror, referuar vendimit nr. 2/2017, të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse<sup>2</sup>.

**16.** Deklarata e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Elona Mihali, iu nënshtrua një hetimi administrativ të thelluar nga Komisioni.

**17.** Në përfundim të hetimit administrativ, kur Komisioni krijoi bindjen se provat kanë nivelin e provueshmërisë, vendosi të mbyllë hetimin kryesisht, t’i japë subjektit të drejtën të njihet me rezultatet e këtij hetimi, si dhe me të gjithë dokumentacionin e administruar në dosje.

<sup>1</sup>“Procedura e vlerësimit të pasurisë I. ILDKPKI-ja, bazuar në deklaratimet e pasurive, zhvillon një procedurë të plotë kontrolli në përputhje me ligjin, “Për deklaratimin dhe kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare të personave të zgjedhur dhe nëpunësve të caktuar publikë”, ligjin “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, si dhe “Kodin e Procedurave Administrative”.

<sup>2</sup>Vendimi nr. 2/2017 i Gjykatës Kushtetuese: “41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit, është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë Komisioni i Pavarur i Kualifikimit gjatë këtij procesi.”

**18.** Në deklaratën e pasurisë për procesin e rivlerësimit, por edhe pas verifikimit administrativ të kryer nga ILDKPKI-ja dhe nga Komisioni, ka rezultuar si vijon:

**1. “Të drejtë përdorimi për apartamentin me sip. 66.6 m<sup>2</sup>, Vlorë.** Apartamenti i përket prindërve të subjektit. Të drejtë përdorimi të përkohshëm (strehim) në apartament, pasuri e prindërve të mi N. M. dhe I. M., apartament që ndodhet në qytetin ku jam emëruar për të ushtruar funksionin si gjyqtare nga muaji janar i vitit 2014 dhe në vazhdim, aktualisht.

*Apartamenti ka sipërfaqe 72 m<sup>2</sup> (sipas Kontratës) dhe sipërfaqe 66.6 m<sup>2</sup> sipas Certifikatës së Pronësisë. Adresa: \*\*\*, Vlorë. Periudha e përdorimit të apartamentit prej meje Elona Mihali, nga muaji janar i vitit 2014 dhe në vazhdim”.*

Subjekti ka shpjeguar në deklaratën Vetting sa vijon: “Periudha e pagesës së kësteve të çmimit të blerjes së apartamentit nga prindërit e mi N. M. dhe I. M. është nga data 2.4.2007 deri më 30.10.2011 (gjithsej 15 këste). Asnjë shpenzim nga ana ime, subjekti Elona Mihali, për blerjen e apartamentit. Shpenzimet për blerjen e apartamentit janë të prindërve të mi N. M. dhe I. M.. Nuk disponoj të drejta pronësie mbi apartamentin.

*Burimi i krijimit të pasurisë së prindërve – Kontratë Prenotimi Shitje (ndërtim apartamenti) nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 2.4.2007, lidhur midis shoqërisë ‘\*\*\*’ sh.p.k. (sipërmarrësi) dhe N. M. (porositësi-babai im), Zyra Noteriale ‘Xh. L.’, Vlorë (ende nuk është formalizuar kontrata e shitblerjes dhe regjistrimi i apartamentit në emrin e babait tim N. M.).*

*Apartamenti është i regjistruar në ZVRPP-në Vlorë në emër të shoqërive ‘\*\*\*’ sh.p.k., ‘\*\*\*’ sh.p.k., ‘\*\*\*’ sh.p.k., fakt që rezulton nga Certifikata për vërtetim pronësie nr. serial \*\*\*, datë lëshimi 11.12.2014, të cilën prindërit e disponojnë fotokopje, pasi janë vendosur në disponim të saj në datën 30.9.2016, më kërkesën e tyre pranë shoqërisë ‘\*\*\*’ sh.p.k., për efekt deklarimi të pasurisë me ligjin nr. 84/2016. Gjithashtu, prindërve nuk u është vendosur në dispozicion nga ana e shoqërisë ‘\*\*\*’ sh.p.k. Kartela e pasurisë për apartamentin, pasi u është bërë me dije se apartamenti është vendosur si kolateral së bashku me apartamentet e tjera të pallatit ku ndodhet për llogari të një shoqërie bankare, e cila ka bllokuar kartelat e pasurive. Asnjë shpenzim për krijimin e pasurisë nga Elona Mihali. Pa të drejta pronësie deklaruesja Elona Mihali”.*

**1.1** Lidhur me këtë pasuri janë administruar këto dokumente: Certifikatë për vërtetim Pronësie nr. \*\*\*, datë 11.12.2014, për apartament me sip. 66.6 m<sup>2</sup>, nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\* në bashkëpronësi të shoqërive “\*\*\*” sh.p.k., “\*\*\*” sh.p.k. dhe “\*\*\*” sh.p.k.; Kontratë Prenotim Shitje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 2.4.2007, me palë shoqëria “\*\*\*” sh.p.k dhe z. N. M. për pronotim apartamenti me sip. 72 m<sup>2</sup>, në vlerën 36.000 euro, në Vlorë. Shlyerja do të bëhet me 8 këste me nga 4.000 euro për periudhën qershor 2007 – gusht 2008; praktika e shoqërisë ‘\*\*\*’; vërtetim nga “ProCredit Bank” datë 24.10.2016, ku vërtetohet se znj. I. M. ka pasur kredi në shumën 600.000 (gjashtëqind mijë) lekë, lëvruar në datën 29.3.2007, e mbyllur në datën 17.1.2008; kredi në shumën 1.200.000 (një milion e dyqind mijë) lekë, lëvruar në datën 22.6.2007, e mbyllur në datën 23.6.2011; kredi në shumën 1.200.000 (një milion e dyqind mijë) lekë, lëvruar në datën 17.1.2008, e mbyllur në datën 23.1.2012; dhe kredi në shumën 800.000 (tetëqind mijë) lekë, lëvruar në datën 29.9.2008, e mbyllur në datën 23.9.2012. Bashkëlidhur kontratat e kredisë.

**1.2** Subjekti i rivlerësimit, i pyetur gjatë hetimit administrativ<sup>3</sup> në lidhje me mundësitë financiare të prindërve dhe burimin e të ardhurave për blerjen e apartamentit në Vlorë, ka shpjeguar se sendi është në bashkëpronësi të prindërve I. dhe N. M.. Burimi i të ardhurave për shlyerjen e çmimit të apartamentit, sikurse janë deklaruar në deklaratën Vetting të vitit 2017 të pasurisë së shtetasve I. dhe N. M., janë:

<sup>3</sup> Shihni përgjigjen nr. 2 të pyetësorit, datë 14.8.2020 dhe përgjigjet e pyetësorit datë 17.8.2020.

- Kursimet e krijuara ndër vite nga aktiviteti biznesi i vogël “tregti artikuj të ndryshëm me pakicë”, regjistruar Person Fizik “I. M.”, datë regjistrimi 27.1.2000, me NIPT \*\*\*, Njësia Bashkiake nr. \*\*\*, Rr. “\*\*\*\*”, p. \*\*\*, dyqani nr. \*\*\*, Tiranë për periudhën 2000 – 2007;
- të ardhura të krijuara në aktivitetin e mësipërm për periudhën 2007 – 2012;
- Kontratë Kredie datë 29.3.2007, me nr. kredie \*\*\*, nr. klienti \*\*\*, lidhur midis “ProCredit Bank” sh.a. (kredidhënësi) dhe znj. I. M.(kredimarrësi), z. N. M.(debitor solidar), shuma 600.000 (gjashtëqind mijë) lekë, afat shlyerje 24 muaj, kredi e likuiduar plotësisht;
- Kontratë Kredie dhe Hipotekimi datë 22.6.2007, me nr. kredie \*\*\*, nr. klienti \*\*\*, lidhur midis “ProCredit Bank” sh.a. (kredidhënësi) dhe znj. I. M.(kredimarrësi), z. N. M.(debitor solidar), shuma 1.200.000 (një milion e dyqind mijë) lekë, afat shlyerje 48 muaj, kredi e likuiduar plotësisht;
- Kontratë Kredie datë 17.1.2008, me nr. kredie \*\*\*, nr. klienti \*\*\*, lidhur midis “ProCredit Bank” sh.a. (kredidhënësi) dhe znj. I. M.(kredimarrësi), z. N. M. (debitor solidar) për shumën e disbursuar 1.200.000 (një milion e dyqind mijë) lekë, afat shlyerje 48 muaj, kredi e likuiduar plotësisht;
- Kontratë Kredie dhe Hipotekimi datë 29.9.2008, me nr. kredie \*\*\*, nr. klienti \*\*\*, lidhur midis “ProCredit Bank” Tiranë sh.a., në cilësinë e kredidhënësit dhe znj. I. M.(kredimarrësi), z. N. M.(debitor solidar), për shumën 800.000 (tetëqind mijë) lekë, afat shlyerje 48 muaj, kredi e likuiduar plotësisht.
- Shlyerja e kredive ka zgjatur deri më 23.9.2012; të ardhura nga përfitimi i pensionit të parakohshëm (suplementar) të ushtarakut për periudhën 2007 – 2012, si dhe kursimet e krijuara nga përfitimi i pensionit për periudhën 4.5.2001 – viti 2007.

**1.3** Në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie, si dhe aftësinë paguese të prindërve të subjektit të rivlerësimit, Komisioni vlerësoi të ardhurat dhe shpenzimet e prindërve të subjektit. Krijimi i pasurisë është në shumën 36.000 (tridhjetë e gjashtë mijë) euro, sipas Kontratës më 2.4.2007 (Kontratë Prenotim Shitje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 2.4.2007) dhe kryerja e pagesave sipas kësteve të mëposhtëme:

- **pagesat e kryera në vitin 2007:** 4.000 (katër mijë) euro (mandatarkëtimi bankar “ProCredit Bank” sh. a., datë 2.4.2007); 4.000 (katër mijë) euro (mandatarkëtimi bankar “ProCredit Bank” sh. a., datë 22.6.2007); 4.000 (katër mijë) euro (mandatarkëtimi bankar “ProCredit Bank” sh. a., datë 13.8.2007); 2.000 (dy mijë) euro (mandatarkëtimi bankar “ProCredit Bank” sh. a., datë 20.10.2007);
- **pagesat e kryera në vitin 2008:** 2.000 (dy mijë) euro (mandatarkëtimi bankar “ProCredit Bank” sh.a., datë 4.1.2008); 2.000 (dy mijë) euro (mandatarkëtimi bankar “ProCredit Bank” sh.a., datë 3.3.2008); 2.000 (dy mijë) euro (mandatarkëtimi bankar “ProCredit Bank” sh.a., datë 3.5.2008); 1.500 (një mijë e pesëqind) euro (mandatarkëtimi bankar “ProCredit Bank” sh.a., datë 30.8.2008); 1.500 (një mijë e pesëqind) euro (mandatarkëtimi bankar “ProCredit Bank” sh.a., datë 31.10.2008);
- **pagesat e kryera në vitin 2009:** 1.000 (një mijë) euro (mandatarkëtimi bankar “ProCredit Bank” sh.a., datë 5.1.2009); 1.000 (një mijë) euro (mandatarkëtimi bankar “ProCredit Bank” sh.a., datë 25.2.2009); 2.950 (dy mijë e nëntëqind e pesëdhjetë) euro (mandatarkëtimi bankar “ProCredit Bank” sh. a., datë 8.9.2009);
- **pagesat e kryera në vitin 2010:** 2.050 (dy mijë e pesëdhjetë) euro (mandatarkëtimi bankar “ProCredit Bank” sh. a., datë 5.1.2010);
- **pagesat e kryera në vitin 2011:** 5.000 (pesë mijë) euro (mandatarkëtimi bankar “ProCredit Bank” sh. a., datë 26.9.2011); 1.000 (një mijë) euro (mandatarkëtimi lëshuar nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., datë 30.10.2011).

**1.4** Të ardhurat në vitet 2004 – 2007, kur është kryer edhe pagesa e kështit të parë, të cilat rezultojnë të kenë qenë të ardhura nga: (i) pagat; (ii) aktiviteti si Person Fizik i znj. I. M., me NIPT \*\*\*; (iii) qiratë; (iv) huat bankare. Shpenzimet të njohura: (i) shpenzime jetike për tri

persona; (ii) shpenzime për shlyerje detyrimi ndaj huadhënësve (“ProCredit Bank” dhe NOA); (iii) shpenzime për kontrata të shërbimeve utilitare (OSSHE, UKT); dhe (iv) shpenzime sipas sistemit TIMS.

Periudha	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011
Të ardhura	1,863,168.00	1,937,456.00	1,001,335.00	3,002,548.00	3,462,770.00	1,297,486.00	1,020,523.00	1,239,962.00
Shpenzime jetese (66%)	281,892.00	328,671.00	328,671.00	409,860.00	409,860.00	273,240.00	273,240.00	273,240.00
Shpenzime të tjera (shlyerje këst- kredie, detyrime ndaj të tremeve)	140,681.40	259,800.00	519,600.00	594,700.00	1,242,577.00	1,071,600.00	1,071,600.00	866,900.00
Kursime	2,235,912.42	228,826.16	246,599.01	254,597.95	269,821.21	287,670.59	29,449.73	29,569.55
<b>Rezultati financiar vjetor<sup>4</sup></b>	<b>3,676,507.02</b>	<b>1,577,811.16</b>	<b>399,663.01</b>	<b>2,252,585.95</b>	<b>2,080,154.21</b>	<b>240,316.59</b>	<b>(294,867.27)</b>	<b>129,391.55</b>

**1.5** Në përfundim, nga vlerësimi i dokumentacionit, ka rezultuar se prindërit e subjektit kanë pasur mundësi financiare me burime të ligjshme për të krijuar pasurinë e sipërcituar në vlerën 36.000 (tridhjetë e gjashtë mijë) euro ose 4.352,760.00 (katër milionë e treqind e pesëdhjetë e dy mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë) lekë.

**2. Të drejtë përdorimi për apartament me sip. 114.6 m<sup>2</sup>, Tiranë.** Apartamenti është në pronësi të prindërve të subjektit. Të drejta përdorimi për shkak vendbanimi të përhershëm, së bashku me prindërit, mbi apartamentin me sip. 114.6 m<sup>2</sup>. Adresa: Njësia Bashkiake nr. \*\*\*, Rr. “\*\*\*\*”, nd. \*\*\*, h. \*\*\*, k. \*\*\*, ap. \*\*\* (shënuar \*\*\*), Tiranë.

Periudha e përdorimit të apartamentit për arsye banimi nga dhjetori i vitit 2008 e në vijimësi. Subjekti ka shpjeguar në deklaratën Vetting se: “Pasuri e prindërve të mi N. M. dhe I. M., në bashkëpronësi me 1/2 pjesë secili, fituar me ‘Kontratë Sipërmarrje’ (për ndërtim apartamenti) nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 21.8.2003, Kontratë Shitblerje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 14.11.2014. Viti i krijimit të pasurisë nga prindërit periudha 21.8.2003 – 1.2.2007, pagesë me këste duke filluar nga momenti i lidhjes së ‘Kontratë Sipërmarrje’ (për ndërtim apartamenti) nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 21.8.2003, Kontratë Shitblerje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 14.11.2004. Viti i krijimit të pasurisë nga prindërit periudha 21.8.2003 – 1.2.2007, pagesë me këste duke filluar nga momenti i lidhjes së ‘Kontratë Sipërmarrje’ (për ndërtim apartamenti) nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 21.8.2003. Viti i formalizimit të Kontratës së Shitblerjes datë 14.11.2014, sendi i regjistruar në datën 10.12.2014. Asnjë shpenzim nga ana ime, subjekti Elona Mihali për blerjen e apartamentit. Shpenzimet për blerjen e apartamentit janë të prindërve të mi N. M. dhe I. M.. Nuk disponoj të drejta pronësie mbi apartamentin”.

Burimi i krijimit të pasurisë: Kontratë Sipërmarrjeje (për ndërtim apartamenti) nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 21.8.2003, realizuar midis shoqërisë ndërtimore “\*\*\*\*” sh.p.k, (sipërmarrësi) dhe z. N. M.(porositësi); Kontratë Shitblerje pasurie të paluajtshme nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 14.11.2014, lidhur midis shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., në cilësinë e shitësit dhe z. N. M.(babai i subjektit) në cilësinë e blerësit. Apartamenti i regjistruar në regjistrat e pasurive të paluajtshme të ZVRPP-së Tiranë, identifikuar pasuria me nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, z. k. \*\*\*, Certifikatë për vërtetim pronësie nr. serial \*\*\*, datë lëshimi 10.12.2014. Asnjë shpenzim për krijimin e pasurisë nga znj. Elona Mihali. Pa të drejta pronësie Elona Mihali.

**2.1** Lidhur me këtë pasuri janë administruar këto dokumente: Çertifikatë për vërtetim Pronësie nr. \*\*\*, datë 11.12.2014, për apartamentin me sip. 114.6 m<sup>2</sup>, nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, vol. \*\*\*, f.\*\*\*, në pronësi të z. N. M.+ kartelë pasurie me të dhëna të njëjta; Kontratë Sipërmarrjeje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 21.8.2003, me palë sipërmarrëse shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., dhe palë

Shënim mbi qarkullimin është përdorur marzhi i fitimit në normën 35%. Për më shumë detaje referojuni “analiza financiare e detajuar” (excel). Shpenzimet e jetesës janë llogaritur sipas vendimit të KPA-së të subjektit E. Islamaj, kursime janë zbritur gjendjet e llogarive bankare sipas rezultateve të hetimit. 4.

porositëse z. Mihali për porositje apartamenti me sip. 127 m<sup>2</sup>, në vlerën 55.760 (pesëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë) euro, Rr. “\*\*\*\*”, Tiranë. Me lidhjen e kontratës do të paguhet shuma 18.000 (tetëmbëdhjetë mijë) euro, me përfundimin si karabina do të paguhet shuma 18.000 (tetëmbëdhjetë mijë) euro, me fillimin e rifiniturës do të paguhet shuma 14.000 (katërmëdhjetë mijë) euro, me dorëzimin e çelësave në dorë do të paguhet shuma 5.760 (pesë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë) euro; Kontratë Shitblerjeje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 14.11.2014, me palë shitëse shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., dhe palë blerëse z. N. M. për blerje apartamenti me sip. 114.6 m<sup>2</sup>, ku palët kanë lidhur kontratën e sipërmarrjes nr. \*\*\* kol., datë 21.8.2003, për çmimin 55.760 (pesëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë) euro. Palët deklarojnë se çmimi është shlyer brenda afateve të përcaktuara në Kontratën e Sipërmarrjes; vërtetim “ProCredit Bank” datë 24.10.2016, ku vërtetohet se znj. I. M. ka pasur kredi në shumën 800.000 (tetëqind mijë) lekë, lëvruar në datën 23.6.2005, e mbyllur në datën 23.6.2007, si dhe kredi në shumën 600.000 (gjashtëqind mijë) lekë, lëvruar në datën 29.3.2007, e mbyllur në datën 17.1.2008. Bashkëlidhur kontratat e kredisë.

**2.2** ZVRPP-ja Tiranë<sup>5</sup> konfirmon pasurinë me nr. \*\*\*, e regjistruar me nr. hipotekor \*\*\*, datë 21.6.2011, pasuri e llojit “apartament”, e ndodhur në Tiranë, rruga/ lagjja “\*\*\*\*”, shk. \*\*\*, k. \*\*\*, ap. \*\*\*, përfituar me Kontratë Shitblerjeje pasurie e paluajtshme me nr.\*\*\* rep., nr.\*\*\* kol., datë 14.11.2014, midis shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., në cilësinë e shitësit dhe z. N. V. M. në cilësinë e palës blerëse. Sipas Kontratës së Shitjes çmimi i blerjes është 55.600.00 (pesëqind e pesëdhjetë mijë e gjashtëqind) lekë, i paguar sipas nenit 4 “Detyrimet e Porositësit”, Kontrata e Sipërmarrjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 21.8.2003, me 4 këste, me lidhjen e Kontratës pagesa 18.000.00 (tetëmbëdhjetë mijë) euro, me përfundimin si karabina pagesa 18.000.00 (tetëmbëdhjetë mijë) euro, me fillimin e rifiniturës 14.000.00 (katërmëdhjetë mijë) euro, me dorëzimin e çelësave 5.760.00 (pesë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë) euro.

**2.3** Subjekti i rivlerësimit, i pyetur gjatë hetimit administrativ<sup>6</sup> në lidhje me mundësitë financiare të prindërve dhe burimin e të ardhurave për blerjen e apartamentit në Tiranë, ka shpjeguar se burimi i të ardhurave për shlyerjen e çmimit të apartamentit është, sikurse është deklaruar në deklaratën *Vetting* të vitit 2017 të pasurisë së prindërve I. M.dhe N. M.:

- të ardhura të mbetura nga aktiviteti në tregun e shitjes së lirë në Gjirokastrë, periudha 2.5.1994 – gusht 1999;
- të ardhurat e krijuara nga biznesi i vogël “tregti artikuj të ndryshëm me pakicë”, regjistruar si Person Fizik “I. M.”, datë regjistrimi 27.1.2000, me NIPT \*\*\*, Tiranë, bashkëlidhur vërtetimi nr. \*\*\* prot., datë 16.1.2017, lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë;
- Kontratë Huaje datë 23.6.2005, me nr. kredie \*\*\*, nr. klienti \*\*\*, lidhur midis “ProCredit Bank” sh. a. (huadhënës) dhe znj. I. M.(huamarrës), z. N. M.(debitor solidar), shuma 800.000 (tetëqind mijë) lekë, afat shlyerje 24 muaj, likuiduar plotësisht;
- Kontratë Kredie datë 29.3.2007, me nr. kredie \*\*\*, nr. klienti \*\*\*, lidhur midis “ProCredit Bank” sh.a. (huadhënës) dhe znj. I. M.(huamarrës), z. N. M.(debitor solidar), shuma 600.000 (gjashtëqind mijë) lekë, afat shlyerje 24 muaj, likuiduar plotësisht;
- të ardhura nga përfitimi i pensionit të parakohshëm (suplementar) të ushtarakut, periudha e përfitimit 4.5.2001 dhe në vijimësi.

**2.4** Në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie, si dhe me aftësinë paguese të prindërve të subjektit, Komisioni vlerësoi të ardhurat dhe shpenzimet e prindërve të subjektit. Krijimi i pasurisë është në shumën 55.760 (pesëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë) euro, sipas Kontratës datë 21.8.2003 (Kontratë Sipërmarrje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 21.8.2003) dhe kryerja e pagesave sipas kësteve të mëposhtme:

- a) **pagesa të kryera në vitin 2003:** 12.000 (dymbëdhjetë mijë) USD, kaluar në llogari të sipërmarrësit në shumën 10.959.00 (dhjetëmijë e nëntëqind e pesëdhjetë e nëntë) euro

<sup>5</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 21.9.2020, nga ZVRPP-ja Tiranë (dosja ILDKPKI, Aneks 4/2).

<sup>6</sup> Shihni përgjigjen nr. 1 të pyetësorit, datë 14.8.2020 dhe përgjigjet e pyetësorit datë 17.8.2020.

(mandatarkëtimi bankar “Fefad Bank” sot “ProCredit Bank” sh.a., datë 22.8.2003); 4.041 (katër mijë e dyzet e një) euro (mandatarkëtimi nr. \*\*\*, lëshuar nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., datë 14.11.2003); 3.000 (tre mijë) euro (mandatarkëtimi *extra*, lëshuar nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., datë 5.12.2003);

- b) **pagesa të kryera në vitin 2004:** 13.000 (trembëdhjetë mijë) euro (mandatarkëtimi bankar “ProCredit Bank” sh.a., datë 27.10.2004); 2.000 (dy mijë) euro (mandatarkëtimi *extra*, lëshuar nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., datë 27.10.2004);
- c) **pagesa të kryera në vitin 2005:** 3.000 (tre mijë) euro (mandatarkëtimi *extra*, lëshuar nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., datë 17.1.2005); 6.000 (gjashtë mijë) euro (mandatarkëtimi *extra*, lëshuar nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., datë 24.6.2005); 2.500 (dymijë e pesëqind) euro (mandatarkëtimi *extra*, lëshuar nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., datë 26.9.2005); 1.500 (një mijë e pesëqind) euro (mandatarkëtimi *extra*, lëshuar nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., datë 11.11.2005);
- d) **pagesa të kryera në vitin 2006:** 1.500 (një mijë e pesëqind) euro (mandatarkëtimi *extra*, lëshuar nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., datë 6.1.2006); 1.500 (një mijë e pesëqind) euro (mandatarkëtimi *extra*, lëshuar nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., datë 31.1.2006); 3.000 (tre mijë) euro (mandatarkëtimi *extra*, lëshuar nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., datë 20.11.2006); 1.000 (një mijë) euro (mandatarkëtimi *extra*, lëshuar nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k.);
- e) **pagesa të kryera në vitin 2007:** 2.760 (dy mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë) euro (mandatarkëtimi *extra*, lëshuar nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., datë 1.2.2007).

**2.5** Të ardhurat në vitet 1999 – 2003, kur është kryer edhe pagesa e këstit të parë, të cilat rezultojnë të kenë qenë të ardhura nga: (i) pagat; (ii) aktiviteti si Person Fizik i znj. I. M, me NIPT \*\*\*; (iii) qiratë; (iv) huat bankare; dhe shpenzimet të njohura: (i) shpenzime jetike për tri persona; (ii) shpenzime për shlyerje detyrimi ndaj huadhënësve (“ProCredit Bank dhe NOA); (iii) shpenzime për kontrata të shërbimeve utilitare (OSSHE, UKT); (iv) shpenzime sipas sistemit *TIMS*.

Periudha	1994-1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007
Të ardhura	1,517,688.00	910,000.00	1,132,084.00	1,288,512.00	1,400,864.00	1,863,168.00	1,937,456.00	1,001,335.00	3,002,548.00
Shpenzime jetese (66%)	324,000.00	324,000.00	324,000.00	281,682.00	281,892.00	281,892.00	328,671.00	328,671.00	409,860.00
Shpenzime të tjera (shlyerje këst-kredie, detyrime ndaj të tretëve)	-	-	-	-	30,000.00	140,681.40	259,800.00	519,600.00	594,700.00
Kursime	8,164,991.00	8,250,591.00	8,250,591.00	8,352,363.63	4,823,778.27	2,235,912.42	228,826.16	246,599.01	254,597.95
<b>Rezultati financiar vjetor<sup>7</sup></b>	<b>9,358,679.00</b>	<b>8,836,591.00</b>	<b>9,058,675.00</b>	<b>9,359,193.63</b>	<b>5,912,750.27</b>	<b>3,676,507.02</b>	<b>1,577,811.16</b>	<b>399,663.01</b>	<b>2,252,585.95</b>

**2.6** Në përfundim, nga vlerësimi i dokumentacionit, ka rezultuar se prindërit e subjektit kanë pasur mundësi financiare me burime të ligjshme për të krijuar pasurinë në vitin 2003, sipas deklaratimit në vlerën 55.600 (pesëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind) euro ose 7.452,324.00 (shtatë milionë e katërqind e pesëdhjetë e dy mijë e treqind e njëzet e katër) lekë.

**3.** Gjatë hetimit ka rezultuar se pasuria nr. 1 dhe nr. 2, të sipërtrajtuara, janë pasuri që përdoren aktualisht edhe nga subjekti i rivlerësimit. Nga hetimi i kryer ato rezultuan pasuri të ligjshme. Pasuritë janë krijuar para fillimit të detyrës për subjektin e rivlerësimit dhe janë pasuri në emër të prindërve të subjektit. Nga hetimi dhe verifikimi i llogarive bankare të prindërve, si dhe nga veprimtaria e tyre tregtare ka rezultuar se këto janë pasuri të krijuara konform legjislacionit në fuqi dhe me burime të ligjshme financimi.

Shënim: mbi qarkullimin është përdorur marzhi i fitimit në normën 35%. Për më shumë detaje referojuni “analiza financiare e detajuar” (excel). Shpenzimet e jetesës janë llogaritur sipas vendimit të KPA-së të subjektit E. Islamaj kursime janë zbritur gjendjet e llogarive bankare sipas rezultateve të hetimit..



4. Subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting* gjendje *cash* në vlerën 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë, ndërsa gjendja e kursimeve *cash* ndër vite dhe në DPV-në e vitit 2010 ka qenë zero.

4.1 Nga printimet, nxjerrja e llogarisë nr. \*\*\* EC në “Tirana Bank”, rezulton se subjekti ka tërhequr në datën 6.1.2017 shumën prej 81.979.00 (tetëdhjetë e një mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e nëntë) lekësh, shumë e cila i korrespondon pagës së muajit dhjetor të vitit 2016.

4.2 Duke konsideruar shpenzimet jetike mujore në shumën 19.837.84 (nëntëmbëdhjetë mijë e tetëqind e tridhjetë e shtatë pikë tetëdhjetë e katër) lekë duket se subjekti, në datën 23.1.2017, në deklaratën *Vetting*, ka pasur mundësi të krijojë gjendje *cash* në shumën 50.000.00 (pesëdhjetë mijë) lekë në banesë.

5. Subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting* për personat e lidhur, prindërit e saj, gjendje *cash* në shumën 900.000 (nëntëqind mijë) lekë.

5.1 Nga analiza financiare e tyre ka rezultuar se të ardhura minus shpenzime të kryera nga prindërit e subjektit (në total), duke zbritur edhe blerjet e pasurive të deklaruara dhe analizuara më lart (duke marrë në konsideratë vetëm të ardhurat dhe shpenzimet e njohura) rezulton se ata kanë pasur mundësi të kursejnë potencialisht shumën e deklaruar si kursim *cash* në banesë (referuar një analize kumulative dhe duke marrë në konsideratë vetëm shpenzime të njohura).

5.2 Referuar shkresës nr. \*\*\* prot., datë 24.8.2020, të “Raiffeisen Bank”, ka rezultuar se z. N. M, babai i subjektit, ka në llogarinë me nr. \*\*\* gjendje në shumën 316,735.35 (treqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e tridhjetë e pesë pikë tridhjetë e pesë) lekë, si dhe depozitë bankare në shumën 100,031.93 (njëqind mijë e tridhjetë e një pikë nëntëdhjetë e tre) lekë.

5.3 Referuar shkresës nr. \*\*\* prot., datë 6.11.2020, rezulton se prindërit e subjektit, N. dhe I. M. kanë një llogari bankare të përbashkët me nr. \*\*\*\*, e cila është çelur më 17.5.2019 dhe ka shërbyer si llogari për depozitim e pagesave mujore nga qiramarrësi “\*\*\*\*” sh.p.k., për ambientin e marrë me qira. Gjendja më 31.12.2019, referuar nxjerrjes së llogarisë, rezulton të jetë në shumën 16,241.02 (gjashtëmbëdhjetë mijë e dyqind e dyzet e një pikë zero dy) euro. Gjendja më 31.10.2020, referuar nxjerrjes së llogarisë, rezulton të jetë në shumën 31,002.26 (tridhjetë e një mijë e dy pikë njëzet e gjashtë) Euro. Sipas kontratave të qirasë rezulton se ambienti me qira është një apartament banimi i blerë nga prindërit e subjektit më 16.5.2000, në Rr. “\*\*\*\*” Tiranë.

## 6. GJETJE TË TJERA

6.1 Nga informacionet e mbledhura nga ZVRPP-ja nuk kanë rezultuar pasuri të tjera në emër të subjektit të rivlerësimit apo prindërve të saj, bashkëlidhur përgjigjet negative të ZVRPP-ve të rretheve.

6.2 **ALUIZNI**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 28.8.2017, konfirmon se subjekti nuk figuron si subjekt aplikues për vetëdeklarimin e ndonjë objekti informal, në funksion të përfshirjes në procesin e legalizimeve.

6.3 **DPSHTRr-ja**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 15.8.2017, konfirmon se subjekti nuk ka automjet të regjistruar në pronësi të saj. Nga sistemi i AMLF-së nuk rezultuan të dhëna për subjektin.

6.4 Subjekti ka deklaruar adresat e saj të banimit në DPV-të, të cilat përputhen me të dhënat e rezultuara gjatë hetimit.

6.5 Nga të dhënat e administruara nga OSHEE-ja dhe UKT-ja ka rezultuar një kontratë aktive me UKT-në për një objekt në Rr. “\*\*\*\*” Tiranë, për kategorinë konsumator familjar në emër të shtetasit N. V. M.. Po ashtu, kanë rezultuar kontrata aktive me OSHEE-në Lushnjë dhe Vlorë.

Nuk rezultojnë kontrata aktive lidhur me pasuritë e deklaruara nga subjekti si pasuri të prindërve.

**6.5.1** Subjekti ka shpjeguar sa vijon: “Mbi pasurinë për të cilën ju ka rezultuar se babai ka kontratë aktive me UKT-në në kategorinë e konsumatorit familjar në rrugën “\*\*\*”, parashtraj se kjo duhet të jetë Kontrata e furnizimit më ujë të pijshëm me UKT-në që i përket apartamentit në pronësi të prindërve me adresë rruga “\*\*\*” përballë postës nr. \*\*\*, shk. \*\*\*, ap. \*\*\*. Duhet të ketë ndodhur ndryshim në emrin e rrugës ose adresat me të cilat OSHEE-ja sh. a. punon nuk përputhen me ato të pasqyruara nga shërbimi i gjendjes civile, pasi nga faturat që më tregojnë babai rezulton se faturat për apartamentin lëshohen nga OSHEE sh.a. në emrin ‘A. M.’, pra me gabim në emër dhe mbiemër dhe me adresën ‘M. Gj.’ me nr. \*\*\* kontrate, ndërsa librezat e pagesës së energjisë elektrike për këtë kontratë e lëshuar po nga ana e OSHEE-së ka të shënuar adresën Rr. ‘\*\*\*’. Babai më informon se ka bërë aplikim dy herë pranë Zyrave të Kujdesit ndaj Klientit për korrigjimin e gabimit në emër dhe mbiemër, duke dorëzuar dokumentet përkatëse, por nuk ka marrë përgjigje. Edhe kjo pasuri është deklaruar në deklaratën Vetting 2017 nga prindërit dhe identifikohet me pasurinë apartament me nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, z. k. \*\*\*. Kopje të faturave dhe të librezës së pagesës për kontratën me OSHEE-në që po m’i vendosin në dispozicion prindërit po i depozitoj si prova.

Në lidhje me pretendimin se ka rezultuar kontratë aktive me OSHEE-në sh.a. në Lushnjë, duhet të ketë pasaktësi në informacionin e marrë, pasi prindërit e mi nuk kanë dhe as nuk kanë pasur ndonjëherë ndonjë pasuri apo kontratë me OSHEE-në në qytetin e Lushnjës. Vlerësoj se duhet të verifikoni më me saktësi informacionin që keni marrë, duke administruar të plotë nga OSHEE-ja dokumentacionin për çeljen e kontratës me OSHEE me qëllim që identifikohen të plotë gjeneratitetet e personit që ka çelur kontratën dhe dokumenti i identifikimit të tij, pasi nuk është as babai im dhe as nëna ime.

Në lidhje me kontratën aktive me OSHEE-në në Vlorë, prindërit disponojnë vetëm apartamentin e deklaruar pasuria me nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, me adresë sipas ZVRRP Vlorë: Rr. “\*\*\*\*”, godina \*\*\*, h. \*\*\*, ap. \*\*\* Vlorë’. Kontrata me OSHEE-në ka qenë aktive dhe është aktive me emrin ‘N. M.’ me nr. \*\*\* konsumator familjar dhe adresa me të cilën OSHEE sh.a. e identifikon dhe lëshon faturat është “L. S. Z., \*\*\*, Vlorë qytet, \*\*\* Konstruksion’. Po paraqes një kopje të librezave të pagimit të energjisë elektrike dhe disa fatura të ruajtura ndër vite, vitet 2011 e në vazhdim, të cilat prindërit mi i vendosin në dispozicion për efekt të përgjigjes ndaj pyetjes.

Ndërsa, në lidhje me pretendimin se sipas jush nuk rezultojnë kontrata aktive lidhur me pasuritë e deklaruara nga prindërit e mi, sqaroj se për dy pasuritë e ndodhura njëra në Vlorë dhe tjetra në rrugën ‘\*\*\*’/Rr. ‘\*\*\*’ i citova më sipër kontratat aktive me OSHEE sha. FSHU. Ndërsa për tre pasuritë e tjera kontratat aktive me OSHEE sh.a., kanë qenë dhe janë si më poshtë:

Për apartamentin e ndodhur në adresën sheshi ‘\*\*\*’ nd. \*\*\*, h. \*\*\*, ap. \*\*\*, i deklaruar në deklaratën Vetting 2017 pasuria me nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, z. k. \*\*\*, sipas ZVRRP-së Tiranë, me adresën Rr. ‘\*\*\*’ h. nr. \*\*\*, ap. \*\*\*, apartamenti ku banojnë aktualisht prindërit, ka kontratë me OSHEE sh.a. me nr. \*\*\* me emrin e shënuar gabim nga OSHEE sh.a. ‘A. M.’ (shtuar emrit një ‘a’ para) konsumator familjar me adresë të shënuar në fatura ‘\*\*\*’. Kopje të librezës së pagesës dhe të faturave të energjisë që po më vendosin në dispozicion prindërit po i paraqes si provë.

Për pasurinë e ndodhur në Tiranë e deklaruar në deklaratën Vetting 2017, me adresë: Rr. ‘\*\*\*’ aktualisht Rr. ‘\*\*\*’ p. \*\*\*, shk. \*\*\*, nr. \*\*\*, aktualisht dyqani nr. \*\*\*, pasuria me nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, z. k. \*\*\*, kontrata me OSHEE-në është aktive me emrin ‘A. M.’ të shënuar nga OSHEE emri gabim (shtuar emrit një ‘a’ para) me nr. kontrate \*\*\* me adresë

*të shënuar nëpër fatura ‘\*\*\*’. Kopje të faturave që po më vendosin në dispozicion prindërit po i paraqes si provë.*

*Për apartamentin e deklaruar në deklaratën Vetting 2017, i ndodhur në Gjirokastrë, regjistruar në regjistrat hipotekorë nr. \*\*\*, datë 17.2.1994, prindërit kanë kontratë me OSHEE sh.a. me nr. \*\*\* me emrin (shtuar emrit një ‘a’ para, hequr germa ‘i’ në fund të emrit) e shënuar gabim nga OSHEE sh.a. ‘A. M.’ konsumator familjar. Kopje të librezës së pagesës së energjisë dhe faturat e energjisë elektrike që po më vendosin në dispozicion prindërit po i paraqes si provë.*

*THEKSOJ SE të dhënat e sipërcituara i kam marrë ditën në të cilën është shtruar pyetja nga ana e KPK-së më 11.12.2020, të dhëna ku përfshihen emra kontratash me OSHEE sh.a., numra kontratash me OSHEE sh.a., librezat pagesash energjie elektrike dhe fatura të konsumit të energjisë, të cilat PRINDËRIT N. M. DHE I. M. m’i vendosën në dispozicion në DATËN 11.12.2020, me qëllim që të kthejë përgjigjen që KPK-ja më ka drejtuar mua. Theksoj se prindërit kanë qenë pagues të rregullt dhe në kohë të detyrimeve për konsumin e ujit të pijshëm ose energjisë elektrike.*

***SQARIM:** Babai më sqaron në lidhje me gabimet në regjistrimin e emrit apo mbiemrit në kontratat me OSHEE sh.a., se çelja e kontratave është bërë duke u dorëzuar prej tij në OSHEE sh.a. kërkesa për çelje kontrate, fotokopje të certifikatës së pasurisë, kopje të kartës së identitetit, por pavarësisht kësaj regjistrimi është shoqëruar me gabime, të cilat edhe kur babai ka bërë kërkesë për korrigjim nuk i kanë kthyer përgjigje nga OSHEE sh.a.”*

**6.5.2** Subjekti, e pyetur në seancën dëgjimore lidhur me shkaqet se pse i drejtohet Komisionit në shpjegimet e saj me shkrime kapitale, hera-herës me *bold* apo me *underline*, ka shpjeguar se e ka bërë për të fokusuar vëmendjen e Komisionit në çështjet/pikat më të rëndësishme të shpjegimeve të saj.

**6.6** Nga të dhënat në Zyrën e Regjistratit Noterial ka rezultuar se në datën 4.2.2020 është lidhur Kontrata e Shitjes me palë N. M. dhe A. L., A. Z., F. M..

Komisioni i ka kërkuar, nëpërmjet komunikimit elektronik, noterit që të vërë në dispozicion kontratën (praktikën e plotë), i cili e ka vendosur atë në dispozicion.

Kjo kontratë është vënë në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit.

**6.7** DPPPP-ja, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 11.5.2017, konfirmon se nuk ka raportime financiare në emër të subjektit të rivlerësimit, ndërsa ka raportuar kontratën e shitjes datë 4.2.2020 dhe një transaksion me vlerë 36.000 (tridhjetë e gjashtë mijë) euro.

**6.7.1** Subjekti, e pyetur lidhur me këtë shkresë, sqaron se: *“Në lidhje me konstatimet vijuese të pyetjes së parë ku referoni në të dhënat që keni konstatuar në regjistrin noterial apo të dhënat që ju janë deklaruar nga Drejtoria e Pastrimit të Parave, vlerësoj, sikurse e konstatoi edhe vetë ju, se **analiza nuk duhet të bazohet ‘në dukje’, por mbi PROVAT e paraqitura në lidhje me kontraktimin për prenotimin, shlyerjen e plotë të kësteve të çmimit të blerjes së apartamentit për periudhën 2.4.2007 – 30.10.2011, për nënshkrimin e Kontratës së Shitjes dhe regjistrimit të sendit në emër të prindërve në ish-ZVRPP Vlorë.***

*Provat që kam dorëzuar pranë KPK-së përbëjnë praktikën e plotë të Kontratës së Shitjes së datës 4.2.2020, e administruar pranë Noteres që ka realizuar kontratën dhe po ashtu një kopje e plotë të kësaj praktike ndodhet e administruar pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Vlorë. Në këtë praktikë gjenden të gjitha mandatpagesat për shlyerjen e kësteve të çmimit të blerjes së apartamentit të prenotuar, depozituar pranë KPK-së në datat 17.8.2020 dhe 11.12.2020.*

*Pagesat për shlyerjen e kësteve janë kryer përmes një banke të vetme, ‘ProCredit Bank’ sh.a., pagesa të cilat të mbledhura së bashku arrijnë shumën 35.000 (tridhjetë e pesë mijë) euro dhe vetëm 1.000 (një mijë) euro është paguar pranë zyrës së financës së shoqërisë ‘\*\*\*’ kur*

prindërit kanë marrë në dorëzim apartamentin, pasi kishin shlyer të plotë detyrimet financiare që kishin ndaj shoqërisë ndërtuese ‘\*\*\*’ sh.p.k., në datën 30.10.2011. Pagesat përmes ‘ProCredit Bank’ sh.a. janë bërë në numrin e llogarisë NR. \*\*\*, të shtetasit A. Z. (shikoni mandatat bankare me përshkrimet përkatëse për ‘pagesë kësti për apartament’), i cili është dhe ka qenë administrator i shoqërisë ndërtuese të pallatit ku ndodhet apartamenti (vetëm kjo shoqëri është ndërtuesja e pallatit shoqëria ‘\*\*\*’ sh.p.k.). Pagesat janë bërë nga N. M.(babai) ose I. M. (nëna).

Kjo do të thotë se që të kuptohet drejt dhe ashtu sikurse është në të vërtetë marrëdhënia kontraktore për prenotimin, likuidimin e plotë të kësteve vite përpara nga prindërit, konkretisht që 9 (nëntë) vite para realizimit të Kontratës së Shitjes së datës 4.2.2020 dhe blerjen e apartamentit duhet të lexohet përmbajtja e plotë e provave të paraqitura nga unë, subjekti e rivlerësimit, dhe prindërit e mi. Konkretisht:

A- Në nenin 3 të Kontratës së Shitjes datë 4.2.2020 është përcaktuar se çmimi i shitjes së sendit është vendosur në vlerën 36.000 euro në Kontratë Prenotimi shitje (ndërtim apartamenti) nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 2.4.2007 dhe citohet se vlera e saj është paguar me këste në bazë të faturave dhe mandatpagesave, të cilat janë administruar nga noterja bashkëlidhur kontratës së shitjes, gjithsej 15 mandate dhe 1 urdhërpagese e brendshme bankare që i përkasin periudhës 2.4.2007 – 30.10.2011, të cilat janë pjesë e praktikës noteriale të kontratës që është realizuar pranë Noteres. Po të shikohen vlerat e paguara në këto mandate tregojnë shlyerjen e plotë të çmimit të shitjes së apartamentit të prenotuar sipas mundësive që prindërit kanë pasur për periudhën 2.4.2007 – 30.10.2011 dhe konkretisht janë:

- mandatarkëtimi bankar ‘ProCredit Bank’ sh.a., datë 2.4.2007, vlera 4.000 euro;
- urdhërpagese e brendshme ‘ProCredit Bank’ sh.a., datë 22.6.2007, vlera 4.000 euro;
- mandatarkëtimi bankar ‘ProCredit Bank’ sh.a., datë 13.8.2007, vlera 4.000 euro;
- mandatarkëtimi bankar ‘ProCredit Bank’ sh.a., datë 20.10.2007, vlera 2.000 euro;
- mandatarkëtimi bankar ‘ProCredit Bank’ sh.a., datë 4.1.2008, vlera 2.000 euro;
- mandatarkëtimi bankar ‘ProCredit Bank’ sh.a., datë 3.3.2008, vlera 2.000 euro;
- mandatarkëtimi bankar ‘ProCredit Bank’ sh.a., datë 3.5.2008, vlera 2.000 euro;
- mandatarkëtimi bankar ‘ProCredit Bank’ sh.a., datë 30.8.2008, vlera 1.500 euro;
- mandatarkëtimi bankar ‘ProCredit Bank’ sh.a., datë 23.10.2008, vlera 1.500 euro;
- dy mandatarkëtime bankare ‘ProCredit Bank’ sh.a., datë 5.1.2009, vlera 1.000 euro;
- mandatarkëtimi bankar ‘ProCredit Bank’ sh.a., datë 25.2.2009, vlera 1.000 euro;
- mandatarkëtimi bankar ‘ProCredit Bank’ sh.a., datë 8.9.2009, vlera 2.950 euro;
- mandatarkëtimi bankar ‘ProCredit Bank’ sh.a., datë 5.1.2010, vlera 2.050 euro;
- mandatarkëtimi bankar ‘ProCredit Bank’ sh.a., datë 26.9.2011, vlera 5.000 euro.

I vetmi mandatarkëtim i lëshuar nga shoqëria ‘\*\*\*’ sh.p.k. është mandati i datës 30.10.2011 mandat likuidimi përfundimtar për blerjen e apartamentit vlera 1.000 euro.

Këto mandate janë dorëzuar prej meje që në datën 27.7.2020, si pjesë e praktikës noteriale të Kontratës së Shitjes së datës 4.2.2020 pranë ILDKPKI-së bashkëlidhur ‘Deklaratës së pasurisë dhe interesave private të kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë’ pranë ILDKPKI-së, ASHTU EDHE pranë KPK-së në këto DATA:

- a) Në datën 17.8.2020 me aktin e protokolluar me nr.\*\*\*, datë 17.8.2020, të titulluar ‘Depozitim dokumentacioni të njehsuar me origjinalin nga subjekti i rivlerësimit, znj. Elona Mihali në përgjigje të pyetjes së shtruar në datën 12.8.2020.’
- b) Ashtu edhe janë dorëzuar prej meje si pjesë e praktikës noteriale për lidhjen e Kontratës së Shitjes së datës 4.2.2020, të dorëzuar në KPK më 11.12.2020, me aktin e protokolluar me nr. \*\*\*, datë 11.12.2020.

Vërtetimi lëshuar nga administratori i shoqërisë ‘\*\*\*’ sh.p.k. z. A. Z. dorëzuar nga prindërit bashkëlidhur deklaratës Vetting 2017 ku vërtetohet likuidimi total i çmimit të blerjes së

apartamentit të prenotuar, si dhe likuidimi i shumës për lidhjen e kontratës së furnizimit me energji elektrike (OSHEE sh.a.) dhe ujë (UKT sh.a.).

Kontrata e shitjes së datës 4.2.2020 përbën dukshëm një veprim juridik të kryer me vonesë nga ana e shoqërisë ‘\*\*\*’ sh.p.k., palë debitore ndaj prenotuesve (babait) që prej datës 30.10.2011. Sipas shpjegimeve të babait vonesa në realizimin e kontratës përfundimtare të shitjes nga shoqëria përgjegjëse ‘\*\*\*’ ka ardhur pasi i gjithë pallati ku ndodhet apartamenti ishte vendosur si kolateral në mënyrë të njëanshme pa dijeni dhe pa miratimin e banoreve (prenotuesve) nga ana e shoqërisë ‘\*\*\*’ sh.p.k. Me zhbllokimin e këtyre pasurive gradualisht nga shoqëria ‘\*\*\*’ sh.p.k. ka nisur të realizohet kalimi përfundimtar i pronësisë së apartamenteve të banorët prenotues të apartamenteve të pallatit që kishin shlyer të plota këstet e blerjes së sendeve/apartamenteve) ndaj shoqërisë ‘\*\*\*’ sh.p.k.

Pra, nga sa më sipër konkludoj se:

**Prindërit e mi nuk kanë bërë KURRË ndonjë transaksion në datën 4.2.2020 për blerjen e pasurisë apartament në Vlorë, pasi NUK KISHIN SE ÇFARË TË PAGUANIN MË, PASI I KISHIN SHLYER TË PLOTA TË GJITHA KËSTET PËRBËRËSE TË ÇMIMIT TË BLERJES SE APARTAMENTIT TË PRENOTUAR, SHLYERJE E CILA KISHTE PËRFUNDUAR OË 9 (NËNTË) VITE MË PARË, PRA OË NË VITIN 2011.**

Për pasojë edhe ky pretendim i juaji sipas të cilit ju duket se ka pasur transaksion nga prindërit në datën 4.2.2020 për blerje apartamenti NUK ËSHTË AS I SAKTË dhe AS I VËRTETË, por duhet të jetë pasojë e mungesës së verifikimeve të plota që duhet të ishin bërë para së arrihej të shtrohej një pyetje e tillë në këtë formë sikurse është shtruar, kur ndërkohë unë, subjekti i rivlerësimit, kam dorëzuar muaj përpara TË GJITHA PROVAT E PLOTA që vërtetojnë dhe tregojnë dukshëm e thjeshtësisht TË VËRTETËN periudhën e shlyerjes së PLOTË të çmimit të sendit, 2.4.2007 - 30.10.2011, kështu për kësht.

Për pasojë edhe deklaramit që kam bërë për periudhën e pagesës 2.4.2007 – 30.10.2011 të kësteve përbërëse të çmimit të blerjes së apartamentit I QËNDROJ, pasi është tërësisht I SAKTË, tërësisht I DETAJUAR, tërësisht I VËRTETUAR si pasojë e korrektesës së lartë që ka karakterizuar PRINDËRIT E MI në ruajtjen ndër vite të të gjithë dokumentacionit në lidhje me prenotimin, shlyerjen e kësteve të çmimit të përcaktuar që në kontratën e prenotimit dhe blerjen e apartamentit (15 mandatpagesat dhe 1 urdhërpagese), prenotim i cili është bërë kur unë kam qenë studente vetëm 19 vjeçe (viti 2007) dhe shlyerja e plotë e çmimit të blerjes së sendit ka përfunduar në vitin 2011 kur unë kam qenë 23 vjeçe, pra vite përpara se të bëhesha gjyqtare.”

**7. Komisioni ka hetuar lidhur me situata të mundshme të konfliktit të interesit, duke pyetur Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku subjekti ka ushtruar veprimtarinë e saj si gjyqtare, lidhur me procese të mundshme gjyqësore, të gjykuara nga gjyqtarja Elona Mihali me palë ndërgjyqëse subjektet: “\*\*\*” sh.p.k., “\*\*\*” sh.p.k., “\*\*\*” sh.p.k., dhe “\*\*\*” sh.p.k.**

**7.1** Nga përgjigjet ka rezultuar vendimi nr. \*\*\*, datë 26.12.2018, i gjyqtarës Elona Mihali, me palë paditëse shoqërinë “\*\*\*” sh.p.k., me seli në Vlorë, Blv. “\*\*\*”, Kompleksi \*\*\*.

**7.2** Në përfundim, nga vlerësimi i të dhënave të rezultuara më sipër arrihet në konkluzionin se: marrëdhënia e prindërve të subjektit me ndërtuesin ka përfunduar në shkurt të vitit 2020 kur është lidhur kontrata e shitblerjes. Subjekti ka banuar në këtë apartament prej një kohe të gjatë, referuar deklaramit të saj ajo ka pasur dijeni lidhur me ndërtuesit e pallatit pasi vetë objekti i porositur dhe blerë prej prindërve të saj rezultonte i bllokuar në bankë për llogari të tri firmave ndërtuese (bashkinvestitore). Ky informacion është vënë në dispozicion nga subjekti në deklaratën Vetting.

Nga hetimi ka rezultuar se subjekti ka shqyrtuar një çështje gjyqësore me palë shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., (A. L., J. L., H. M. dhe F. M.) në datën 26.12.2018, për të cilën duket se ajo ka gjykuar në kushtet e konfliktit të interesit.

**7.3** Subjekti, e pyetur për këtë *indicie* të mbledhur gjatë hetimit, ka sqaruar se: “Në lidhje me konstatimin në fjalinë e parë të pyetjes së parë ku pretendoni se nuk kam informuar KPK-në më parë se data 10.12.2020, në lidhje me Kontratën e Shitjes të datës 4.2.2020, **NUK OËNDRON** pasi:

*Me aktin ‘Përgjigjet ndaj pyetësorit standard nga subjekti i rivlerësimit Elona Mihali’ të dorëzuar pranë KPK-së me nr. \*\*\* prot., datë 12.8.2020, të dorëzuar prej meje, subjekti i vlerësimit Elona Mihali, KAM INFORMUAR KPK-në plotësisht në lidhje si me ekzistencën e Kontratës së Shitjes të datës 4.2.2020 (duke identifikuar të plotë në ekstremitet e saj dhe pasojat që ka sjellë në regjistrimin e pasurisë në emër të prindërve), ashtu edhe mbi deklaratën e pasurisë datë 27.7.2020, ku është deklaruar kjo kontratë dhe është dorëzuar fizikisht sipas kërkesave ligjore edhe pranë ILDKPKI, që para se të dërgoheshin pyetje për herë të parë nga KPK-ja.*

...

*Ndërsa pyetja shtesë e KPK-së, së cilës i kam kthyer përgjigje në datën 14.8.2020 ka pasur si objekt të saj vetëm deklarin në lidhje me mundësitë financiare të prindërve për blerjen e pasurisë, pyetje të cilën e kam prezumuar se është shtruar nga ana e KPK-së pasi ishte lexuar përmbajtja e përgjigjeve të dorëzuara prej meje dy ditë përpara më 12.8.2020, ku ishte deklaruar edhe Kontrata e Shitjes datë 4.2.2020.*

...

*Në lidhje me pyetjen e shtruar për vendimin e datës 26.12.2018 me palë shoqëria ‘\*\*\*\*’ sh.p.k., (A. L., J. L., H. M., F. M.), shpjegoj se:*

*Nga verifikimi që bëra në sistemin ICMIS të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë rezulton se ‘kam shqyrtuar çështjen me palët ndërgjyqëse paditës ‘\*\*\*\*’ sh.p.k., A. L., J. L., H. M., F. M., i paditur Banka Kombëtare Tregtare sh.a., person i tretë Shoqëria Përmbartimore ‘\*\*\*\*’ me objekt pavlefshmëri titulli ekzekutiv.*

*Në lidhje me këtë çështje rezulton të kem disponuar me vendimin nr. \*\*\*, datë 26.12.2018. Nga përmbajtja e këtij vendimi konstatoj se vendimmarrja është marrë në Dhomë Këshillimi, pasi pala paditëse që në fillim të fazës së veprimeve paraprake që ndiqen në Dhomë Këshillimi, ka paraqitur kërkesë për heqjen dorë nga padia, duke disponuar kështu Gjykata sipas nenit 201/a të Kodit të Procedurës Civile të ndryshuar, në të cilin parashikohet se: ‘Paditësi në çdo fazë të gjykimit mund të heqë dorë krejtësisht ose pjesërisht nga e drejta e padisë. **Në këtë rast padia rrëzohet dhe paditësi nuk ka të drejtë të ngrejë përsëri po këtë padi.** Heqja dorë nga e drejta e padisë përpara gjykatës së apelit sjell si rrjedhojë prishjen e vendimit të gjykatës të shkallës së parë dhe rrëzimin e padisë.’*

*Konstatoj se shqyrtimi i kësaj çështjeje është ndërprerë që në fazë të hershme të saj, duke disponuar në dhomë këshillimi **pa zhvilluar ndonjë seancë me palët**, pra që në fillim të veprimeve paraprake. Kështu konstatoj se nuk kam pasur mundësinë të vlerësoj rastin nëse ka pasur ose jo konflikt interesi nëse ka pasur shkak për heqje dorë, edhe për faktin se nuk i kam pasur në vëmendje si emrat e shoqërive \*\*\* apo \*\*\* ashtu edhe nëse këto të fundit kishin lidhje me regjistrimin e apartamentit të prindërve, pasi emrat e këtyre dy shoqërive **nuk më kanë rezultuar në asnjë nga aktet e dokumentet që babai më kishte vendosur në dispozicion në lidhje me apartamentin e prenotuar prej tij.** Deri para vitit 2020 babai më kishte vendosur në dispozicion vetëm Kontratën e prenotimit të apartamentit të vitit 2007 dhe mandatpagesat (15 mandatpagesa dhe një urdhërpagese) që kishte shlyer të plotë çmimin e blerjes së apartamentit ndaj shoqërisë ‘\*\*\*\*’ sh.p.k., **dokumente në të cilat kudo rezulton***

*sipërmarrëse dhe ndërtuese e apartamentit me Lejen nr. \*\*\*, datë 27.7.2005 (shihni faqen 1 të Kontratës së Prenotimit datë 2.4.2007) vetëm shoqëria ‘\*\*\*’ sh.p.k. me administrator A. Z., te llogaria bankare e të cilit ishin bërë edhe të gjitha pagesat nga prindërit për shlyerjen e kësteve të çmimit të apartamentit.*

*Pra, deri para datës 4.2.2020 babai nuk më ka dhënë asnjë akt apo asnjë dokument në lidhje me apartamentin në Vlorë, ku të rezultonin shoqëritë ‘\*\*\*’ apo ‘\*\*\*’, përkundrazi nga të gjitha aktet që babai më kishte dhënë rezultonte vetëm shoqëria ‘\*\*\*’ dhe emri i administratorit A. Z.. Gjithashtu, babai nuk më ka folur ndonjëherë dhe as nuk m’i ka përmendur ndonjëherë këto emra shoqërisht \*\*\* apo \*\*\*, deri në datën kur lidhi Kontratën e Shitjes 4.2.2020, e cila ishte edhe dita e parë ku edhe babai më shpjegon se i ka parë për herë të parë përfaqësuesit e këtyre subjekteve në momentin e nënshkrimit të kontratës së shitjes para noterit, përfaqësues të cilët ishin thirrur nga administratori i shoqërisë ‘\*\*\*’ z. A. Z.. Gjithashtu, prindërit nuk kanë pasur asnjë lloj njohje apo marrëdhënie kontraktore të çdolloj natyre me këto dy shoqëri apo përfaqësuesit e tyre, përveç datës së nënshkrimit të Kontratës së Shitjes 4.2.2020 nga babai.*

*Ndërkohë, plotësimi i deklaratës Vetting 2017 nga ana ime është bërë duke e marrë të gatshme ‘copy-paste’ deklarinimin që prindërit kishin bërë në lidhje me këtë pasuri, prandaj edhe kjo rrethanë ka ngelur jashtë vëmendjes sime për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar, vetë procesit voluminoz që kërkohej në një kohë të shkurtër për gjetjen e dokumentacionit plotësimin dhe deklaratës Vetting e mbi të gjitha për shkak se prindërit nuk më kishin dhënë asnjëherë dokumente apo as nuk m’i kishin përmendur ndonjëherë këto emra shoqërisht të tjera.*

*Nëse do kisha konstatuar qoftë edhe ndonjë lidhje sado të vogël të emrave të dy shoqërive Algan dhe Licaj, për periudhën e shkurtër që kam shqyrtuar çështjen në dhomë këshillimi (deri në fillim të veprimeve paraprake), do të kisha parashtruar kërkesën për heqjen dorë nga gjykimi **standard të cilin e kam zbatuar në çdo rast** kur kam pasur në gjykim subjekte që lidheshin me apartamentin, sikurse rasti i shoqërisë ‘\*\*\*’ apo administratorit të saj A. Z.<sup>[1]</sup>. Kam vlerësuar gjithashtu të heq dorë edhe në ato raste ku shtetasi A. Z. është shfaqur si administrator në shoqëri të tjera të ndryshme nga ‘\*\*\*’ sh.p.k. (p.sh.: shoqëria \*\*\*/\*\*\*), raste në të cilët kam bërë verifikimet përkatëse me palët në seancë duke u shtruar pyetjen nëse shtetasi A. Z. që shfaqej si përfaqësues i shoqërisë palë në proces ishte i njëjti person i cili ishte administrator edhe në shoqërinë ‘\*\*\*’ sh.p.k., verifikim pas të cilit kam paraqitur kërkesën për heqjen dorë nga gjykimi i çështjes. Ndërsa në rastin për të cilin ju shtroni pyetjen **unë nuk kam zhvilluar asnjë seancë qoftë edhe pregtitore me palët**, pra nuk kam pasur mundësi të verifikoja të dhënat për shoqërinë Licaj apo subjekte të tjerë, edhe nëse do t’i kisha pasur të memorizuara emrat e shoqërive apo të dhënat e tyre të domosdoshme identifikuese si administrator, NIPT, seli apo lidhjen e tyre të mundshme me apartamentin e prindërve, subjekte tërësisht të panjohur prej meje. Theksoj këtë rrethanë pasi ballafaqimi me palët në seancën e parë ku shpallet përbërja e trupit gjykues është një element procedural i rëndësishëm për të vlerësuar si palët ashtu edhe gjykata nëse ka ndonjë shkak për të hequr dorë, moment i cili në këtë në këtë rast nuk u arrit të zhvillohej, pasi pala hoqi dorë nga çështja në kohë të shkurtër në fillim të veprimeve paraprake që zhvillohen në dhomë këshillimi.*

*Ndërkohë me aktin Certifikatë Pronësie ku apartamenti i prenotuar nga prindërit përfshinte jo vetëm shoqërinë ‘\*\*\*’ sh.p.k., por edhe dy shoqëri të tjera \*\*\* dhe \*\*\* jam njohur për herë të parë në momentin që babai më vendosi në dispozicion praktikën e plotë të lidhjes para noterit të Kontratës së Shitjes së datës 4.2.2020, për ta pasur në konsideratë gjatë punës për të paraqitur kërkesat për heqje dorë nga gjykimi në rast të paraqitjes së këtyre subjekteve apo përfaqësuesve të tyre. Bazuar në praktikën e plotë të kësaj kontrate ku përfshihej certifikata e pronësisë me tre emra shoqërisht kam bërë edhe deklarinimin përkatës si pranë ILDKPKI-së më 27.7.2020, ashtu edhe pranë KPK-së në përgjigjet që kam dhënë ndaj pyetësorit standard të dorëzuara prej meje në datën 12.8.2020.*

Përdorimi i apartamentit në Vlorë prej meje më është lejuar nga prindërit e mi, vite pasi ata kishin filluar ta përdornin apartamentin, pra në lidhje me këtë apartament marrëdhënien e kam pasur vetëm me prindërit e mi.

Nga ana tjetër edhe prindërit e mi e kanë fituar të drejtën për të banuar në apartament nga shoqëria '\*\*\*' sh.p.k., dhe sipas dokumenteve që babai po më vendos në dispozicion rezulton se edhe pasi kanë filluar të banojnë në të në vitin 2011 dhe në vijim të gjitha marrëdhëniet e tjera plotësuese si ato të mirëmbajtjes dhe administrimit të pallatit, si dhe për kalimin e kontratave për furnizimin me energji elektrike dhe ujë të pijshëm, kanë qenë dhe janë vetëm me shoqërinë '\*\*\*' sh.p.k. **Këto dokumente po i paraqes si prova.** Edhe aktualisht, ashtu sikurse gjatë gjithë periudhës së përdorimit të apartamentit në Vlorë, detyrimet në lidhje me administrimin e pallatit, si mirëmbajtje (ashensor, administrator), janë ndjekur dhe janë paguar nga prindërit e mi me shoqërinë '\*\*\*' sh.p.k. dhe asnjëherë nuk janë ndjekur prej meje.

Gjithashtu, asnjëherë nuk kam pasur ndonjëherë në gjykim çështje me këto dy shoqëri \*\*\* apo \*\*\*, apo përfaqësuesit e tyre gjatë viteve të punës, për rrjedhojë nuk i njihja këto subjekte.

Në përgjigje të pyetjes suaj, gjykoj se kjo çështje e zhvilluar deri në fillimin e veprimeve paraprake, në raport me ligjin për 'Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike' rezulton se nuk ka vendimmarrje për themelin pasojë të vlerësimit të fakteve dhe provave në atë kuptim që parashikon ligji 'Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike' në nenin 4/2 të tij, pasi mungon vendimmarrja, mungon objekti, mungon lënda për të gjetur zbatim ligji për parandalimin e konfliktit të interesit. Neni 4/2 parashikon: '2. Për qëllimet e këtij ligji: a) vendimmarrje për një akt do të vlerësohet, në çdo rast, çasti i fundit i procesit vendimmarrës, gjatë të cilit vendoset përmbajtja përfundimtare e aktit; b) vendimmarrje për një akt do të vlerësohen edhe ato çaste paraprake të vendimmarrjes, sipas shkronjës 'a' të kësaj pike, të cilat janë thelbësisht të rëndësishme dhe përcaktuese për përmbajtjen përfundimtare të aktit; c) një zyrtar'' ka kompetencë thelbësore dhe përcaktuese për një akt, nëse pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi i tij në vendimmarrjen për këtë akt, sipas shkronjave 'a' ose 'b' të kësaj pike, përcaktojnë përmbajtjen e aktit.' Nisur nga përcaktimi në nenin 4/2 të Ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, 'Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike' mungon në rastin konkret objekti apo e lënda për të gjetur zbatim ky ligj. Në referim të nenit 4/2 të ligjit në raport me punën e gjyqtarit me akt do të kuptohet çështja ndërsa me përmbajtje do të kuptohet zgjidhja e çështjes. **Nisur nga natyra e vendimit ngushtësisht procedural, i cili ka ardhur nga zbatimi i drejtpërdrejtë i nenit 201/a të Kodit të Procedurës Civile me parashikim eksplicit në lidhje me llojin e vendimit, konstatohet se vendimi nuk përbën vendimmarrje sipas kuptimit dhe kritereve formale të ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit, pasi nuk ka qenë i rëndësishëm apo përcaktues në zgjidhjen përfundimtare në themel të çështjes, pasi nuk kam ushtruar në rastin konkret ndonjë kompetencë për vlerësimin në themel të padisë, as nuk kam shprehur ndonjë lloj qëndrimi apo bindjen time të brendshme mbi faktet, provat dhe pretendimet objekt padie, të tilla që të diktonin në llojin e vendimit për zgjidhjen në themel të çështjes sikurse pranimin e saj, pranimin e pjesshëm apo rrëzimin e saj mbi gjetjen e saj të bazuar ose jo në prova dhe në ligj.**

**Pra, kjo është rrethana në të cilën është zhvilluar shqyrtimi i çështjes. Sa sqarova më sipër janë pasqyrim i sinqeritet dhe dinjiteti tim. E thënë në mënyrë të plotë, në kushtet kur në punën time si gjyqtare jam drejtuar gjithmonë nga parimet e mia të brendshme e plotësisht të ndërgjegjshme për të qenë korrekte në çdo aspekt si në raport me ligjin dhe me veten në çdo rast, në çdo vendimmarrje, në çdo veprim në kuadër të detyrës si gjyqtare dhe jashtë saj, si dhe në kushtet kur kam treguar një transparencë të plotë, me deklaratime pasurie të sakta e në kohë si periodike dhe ashtu edhe në çdo deklaratë tjetër pasurie të kërkuar rast pas rasti, si Vetting e të tjerë, si dhe në kushtet kur edhe ish-personat e lidhur me mua prindërit e mi kanë treguar, pavarësisht moshës së tyre, një angazhim shembullor, tepër serioz dhe plotësisht bashkëpunues në drejtim të zbardhjes dhe pasqyrimin sa më të plotë të punës dhe**



*pasurisë së vënë prej tyre nga puna ndër vite në mënyrë të tejet të përkushtuar dhe tejet korrekte në raport me shtetin dhe të tretët, nuk konstatoj objektivisht asnjë motiv apo qëllim se pse unë do të vlerësoja me ndërgjegje të vazhdoja gjykimin e një çështjeje me të cilën me bindjen time të brendshme apo qoftë edhe në perceptim do të cenonte parimin e paanësisë. Jo vetëm në këto tetë vite të ushtrimit të detyrës si gjyqtare, por edhe në konceptin dhe ndërgjegjen time profesionale të lidhur ngushtësisht me formimin dhe edukimin tim njerëzor, nuk bëhet fjalë kurrë që unë të cenoj paanësinë, drejtësi-dhënien, pavarësinë dhe përgjegjshmërinë e një gjykimi që ka të bëjë me qytetarët e Republikës.*

- <sup>[1]</sup> Nga verifikimi në sistemin ICMIS rastet kur kam paraqitur kërkesë për heqje dorë nga gjykimi janë çështja nr. \*\*\* regj. them., me palë Banka Kombëtare Tregtare, person i tretë (Debitor) ‘\*\*\*’ sh.p.k.; çështja me nr. \*\*\* regj. them., me palët paditës shoqëria ‘\*\*\*’ Vlorë, i paditur shoqëria përmbartimore ‘\*\*\*’ sh.p.k., person i tretë ‘Union Bank’ sh.a. Çështja me nr. \*\*\* regj. them., datë regjistrimi me palë kërkues \*\*\* Vlorë, personi i tretë – Th. Dh. etj.”

7.4 Në përfundim të hetimit, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të shpjeguar lidhur me konstatimet e Komisionit dhe veprimet e saj si gjyqtare në përputhje me legjislacionin në fuqi, nëse ka vepruar në kushtet e konfliktit të interesit lidhur me shqyrtimin e kësaj çështjeje, kur është paraqitur kërkesëpadia në gjykatë dhe kur është caktuar në këtë çështje si gjyqtare. Komisioni i ka kërkuar subjektit të paraqesë prova dhe shpjegime.

7.5 Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar në vijim të rezultateve të hetimit si vijon:

- **“Së pari, unë nuk kam qenë në kushtet e konfliktit të interesit në shqyrtimin e çështjes në referim të Ligjit ‘Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike’, pasi:**

- *Unë nuk kam pasur ndonjëherë dhe as nuk kam me subjektin në gjykim \*\*\* sh.p.k., asnjë lloj marrëdhënie që mund të përshijë të drejta apo detyrime pasurore apo jopasurore të çdolloj natyre nga ato që rendit neni 5 i Ligjit “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”.*

- *Jo vetëm që unë nuk kam asnjë lloj raporti nga ato që rendit neni 5 i Ligjit me subjektin në gjykim ‘\*\*\*’ sh.p.k., por nuk kam asnjë lloj njohje me subjektin \*\*\* sh.p.k., apo përfaqësuesin e tij.*

- *Kanë qenë prindërit e mi ata të cilët më kanë lejuar të qëndroj përkohësisht në apartamentin e tyre në Vlorë dhe ky qëndrim nga ana ime aty nuk është shoqëruar me ndonjë detyrim financiar ndaj prindërve përgjatë gjithë kohës së qëndrimit tim në të. Edhe tarifat për administrimin dhe mirëmbajtjen e ambienteve të përbashkëta të pallatit ku ndodhet apartamenti i prindërve, administrim i cili është kryer që prej vitit 2011 dhe në vazhdim nga shoqëria ndërtuese ‘\*\*\*’ sh.p.k., i kanë ndjekur vetëm prindërit e mi dhe janë këta të fundit që kryejnë këto pagesa vjetore.*

- *Të drejtën për ta përdorur apartamentin prindërit e mi e kanë fituar nga shoqëria ‘\*\*\*’ sh.p.k., që në vitin 2011 dhe në vazhdim pa ndërprerje.*

...

- **Së dyti, nuk jam ndodhur përballë asnjërit prej shkaqeve ligjore që rendit neni 72 i Kodit të Procedurës Civile për të parashtruar kërkesë për heqje dorë nga gjykimi. Kodi i Procedurës Civile parashikon në nenin 72/3: “Gjyqtari është i detyruar të heqë dorë nga gjykimi i një çështjeje konkrete kur: 3. ai vetë ose bashkëshortja e tij janë në konflikt gjyqësor ose në armiqësi apo në marrëdhënie kredie apo huaje me njërin prej palëve, ose njërin prej përfaqësuesve;” Kodi i Procedurës Civile ka një parashikim shume herë më të ngushtë në raport me parashikimin e Ligjit “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, pasi vlerëson si subjekte të papajtueshme me gjyqtarin ato subjekte me të cilat vetë gjyqtari ose bashkëshorti/ja kanë marrëdhënie kredie, huaje, mosmarrëveshje gjyqësore ose armiqësi, duke mos parashikuar subjekte të tjera apo**

marrëdhënie të tjera. Në rastin konkret, jo vetëm që nuk gjen parashikim ky nen, por sikurse u theksua më lart rasti është i tillë ku as unë dhe as prindërit e mi jo vetëm nuk kishim as marrëdhënie kontraktore apo financiare me “\*\*\*” sh.p.k. por as nuk kemi njohje me të.

...

- **Së treti**, e vetmja premisë që do të kishte shërbyer për dorëheqje nga çështja në këtë rast **do të kishte qenë vetëm ruajtja e perceptimit të paanësisë referuar elaburimit të këtij para nga praktika e Gjykatës Kushtetuese në Vendimet nr. 11, datë 5.4.2013, Nr. 12, datë 13.4.2007 dhe Nr. 38, datë 15.10.2007 të saj.** Në referim të ruajtjes së perceptimit të paanësisë kam parashtruar kërkesën për heqjen dore nga gjykimi me shoqërinë “\*\*\*” sh.p.k. apo administratorin e saj A. Z. kur janë shfaqur si subjekte në gjykim, si subjekte me të cilët prindërit kishin pasur marrëdhënie kontraktore ashtu edhe financiare (shlyerja e çmimit të blerjes së apartamentit). Ndërsa në rastin e “\*\*\*” sh.p.k., **ka një diferencë të madhe** pasi ky subjekt nuk ka pasur ndonjëherë asnjë kontratë, asnjë marrëdhënie financiare dhe asnjë lloj njohje me prindërit e mi apo aq më pak me mua. Në këto kushte vlerësimi i perceptimit të paanësisë në rastin e çështjes për të cilën shtrohet pyetja me subjektin “\*\*\*” sh.p.k. **mbetet tepër relativ** në krahasim me rastin kur subjekt në gjykim ka qenë shoqëria “\*\*\*” apo shtetasi A. Z. me të cilët prindërit e mi kanë pasur marrëdhënie si kontraktore ashtu edhe financiare në lidhje me apartamentin tashmë në pronësi të tyre që prej datës 30.10.2011.

***Perceptimi i paanësisë sipas interpretimit të Gjykatës Kushtetuese përbën garanci shtesë për gjykimin, por mbetet gjithashtu relativ, pasi në praktikën e punës më ka rezultuar të jem njohur me ankesën të një qytetare, e cila kundërshton heqjen dorë që kam bërë në rastin kur në gjykim ka qenë subjekti A. Z. pra, administratori i shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k., duke parashtruar se rrethana që kam paraqitur për të hequr dorë nuk përbën rrethanë që ndikon në perceptimin e saj për paanësinë e gjyqtarës në gjykimin e çështjes ku ajo është palë dhe nuk është rrethanë e parashikuar në Kodin e Procedurës Civile si shkak për dorëheqje nga gjykimi. E vendos në dukje këtë ankesë, për të parashtruar atë çfarë në bindjen time të brendshme nga puna ndër vite është konkluduar, e pikërisht se aftësia që një gjyqtar ka për të qenë i paanshëm dhe për ta përcjellë këtë cilësi në mënyrë konsekuente te perceptimi i subjekteve ndërgjyqës, është një aftësi e cila nuk mund të vlerësohet mbi bazën e një rasti sporadik, por përbën aftësinë e tij për të qëndruar i ftohtë dhe objektiv në vlerësim dhe gjykim përballë çdolloj subjekti që shfaqet si ndërgjyqës. Bashkëlidhur ankesa e subjektit datë 20.9.2019.***

***Raporti im ligjor me prindërit ka ndryshuar që prej datës 14.10.2016.***

***Prindërit e mi nuk kanë qenë dhe nuk janë më ‘persona të lidhur’ me mua subjektin e rivlerësimit, që prej datës 14.10.2016, duke filluar që dy vjet më parë se çështja për të cilën shtrohet pyetja e Dhjetor 2018.***

...

***Prindërit janë bërë pronarë “de jure” dhe “de facto” të pasurisë apartament të ndodhur në Vlorë që në datën 30.10.2011, pra shtatë vjet më parë sesa çështja për të cilën shtroni pyetjen, çështje e vitit 2018. Ky konkluzion rezulton nga referimi në legjislacionin material civil në fuqi që nga momenti i lidhjes së kontratës së prenotimit të shitjes ndërtim apartamenti datë 2.4.2007, Kodi Civil ashtu edhe nga parashikimet që janë bërë në këtë kontratë mes palëve.***

***Marrëdhëniet kontraktore dhe financiare të prindërve deri para muajit shkurt 2020 (ndërkohë vendimi është dhënë në dhjetor 2018) kanë qenë vetëm me shoqërinë “\*\*\*” sh.p.k. dhe vetëm me administratorin e saj A. Z..***

...

**Si konkluzione, për sa më sipër parashtrova në këtë rubrikë, rubrika "I", vlerësoj se:**

- 1) ***Nuk kam disponuar me vendimin nr. \*\*\*, datë 26.12.2018, në kushtet e konfliktit të interesit sipas kuptimit të Ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, të ndryshuar, 'Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike' (neni 3/1 të Ligjit) dhe vlerësoj se as nuk jam ndodhur në kushtet e dorëheqjes sipas ndonjë prej parashikimeve të shprehura të Kodit të Procedurës Civile.***
- 2) ***Në nenin 3/1 të Ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, të ndryshuar, parashikohet: "1. "Konflikt i interesit" është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave private të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa private, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësive të tij publike." Si vendimi që kam disponuar ashtu dhe veprimet e pakta procedurale që kam kryer, sikurse më sipërshpjeguar, nuk kanë asnjë tregues qoftë edhe në dukje që të përbëjë kryerje në mënyrë të padrejtë të detyrës publike në kuptim të nenit 3/1, të Ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, i ndryshuar, apo që të tregojë ndikim qoftë edhe në dukje në përmbushjen e detyrës në mënyrë të padrejtë.***
- 3) ***Edhe në këndvështrim të perceptimit të paanësisë, veprimet procedurale të pakta që kam kryer dhe vetë natyra procedurale e vendimmarrjes, për të gjitha specifikat si më sipër kam shpjeguar, vlerësoj se as nuk e kanë cenuar dhe as nuk ndikuar në perceptimin e paanësisë."***

**7.6** Subjekti, e pyetur në seancën dëgjimore lidhur me shkaqet se pse i drejtohet Komisionit në shpjegimet e saj me shkrime kapitale, hera-herës me *bold* apo me *underline*, ka shpjeguar se e ka bërë për të fokusuar vëmendjen e Komisionit në çështjet/pikat më të rëndësishme të shpjegimeve të saj.

**7.7** Në përfundim, lidhur me rubrikën gjetje të tjera, si dhe me barrën e provës të kaluar subjektit të rivlerësimit lidhur me shqyrtimin e çështjes gjyqësore, vendimi nr. \*\*\*, datë 26.12.2018, i gjyqtarës Elona Mihali, me palë paditëse shoqëria "\*\*\*\*" sh.p.k., me seli në Vlorë, Blv. "\*\*\*\*", kompleksi \*\*\*, përfunduar me pushim të shqyrtimit gjyqësor – trupi gjykues ka vlerësuar se shpjegimet e subjektit janë të mjaftueshme dhe bindëse, pavarësisht mënyrës së saj të komunikimit me Komisionin, përsëritjes së tejkujatur të rrethanave dhe shpjegimeve, vlerësohet se ato kanë qenë bindëse për trupin gjykues, për të mos ngarkuar subjektin me ndonjë mangësi për procesin e saj të rivlerësimit.

## **8. Analiza financiare për vitet 2012 - 2016**

**8.1** Në analizën financiare janë llogaritur shpenzimet për udhëtime jashtë shtetit, konkretisht lëvizjet hyrëse - dalëse nëpërmjet të dhënave në sistemin *TIMS*, të subjektit të rivlerësimit dhe familjarëve, si dhe u krahasuan me deklaratimet e subjektit<sup>8</sup>. Për përllogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit janë marrë si referencë deklaratimet e subjektit mbi kostot e shpenzuara për secilin udhëtim, si dhe vendimi nr. 11/2019 (JR), datë 22.5.2019, i KPA-së.

**8.2** Janë marrë në konsideratë deklaratimet e subjektit në DPV-të (2012 – 2016) dhe deklaratën *Vetting* lidhur me kursimet *cash*, si dhe llogaritur shpenzimet jetike dhe shpenzime të tjera të deklaruara.

<sup>8</sup> Përgjigjet e pyetësorit datë 15.2.2019 dhe përgjigjet e pyetësorit datë 10.8.2020.

	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	Deklarata Vetting
<b>PASURI</b>	-	50.27	0.40	9,450.41	18.94	30,068.43	573.25	50,267.39
Likuiditete ne banke	-	50.27	0.40	9,450.41	18.94	30,068.43	573.25	267.39
CASH								50,000.00
<b>DETYRIME</b>	-	-	-	-	-	-	-	-
<b>TE ARDHURA te dokumentuara</b>	<b>127,500.00</b>	<b>512,550.00</b>	<b>194,840.00</b>	<b>1,233,930.00</b>	<b>992,308.00</b>	<b>1,129,464.00</b>	<b>1,055,604.00</b>	<b>1,054,396.00</b>
Te ardhura nga paga e subjektit	127,500.00	512,550.00	194,840.00	1,233,930.00	992,308.00	1,129,464.00	1,055,604.00	1,054,396.00
<b>SHPENZIME</b>	<b>136,620.00</b>	<b>136,620.00</b>	<b>139,548.00</b>	<b>141,024.00</b>	<b>219,998.00</b>	<b>224,276.00</b>	<b>235,092.00</b>	<b>238,054.05</b>
Shpenzime jetese	136,620.00	136,620.00	139,548.00	141,024.00	219,998.00	224,276.00	235,092.00	238,054.05
<b>ANALIZA E DOKUMENTUAR</b>	<b>(9,120.00)</b>	<b>375,879.73</b>	<b>55,341.87</b>	<b>1,083,455.99</b>	<b>781,741.47</b>	<b>875,138.51</b>	<b>850,007.18</b>	<b>766,647.81</b>

### 8.3 Analiza financiare e kryer nga Komisioni për subjektin e rivlerësimit ka rezultuar me balancë pozitive.

9. Nga analiza financiare e kryer për personat e lidhur me subjektin e rivlerësimit, prindërit e saj, si dhe pasuritë e deklaruara prej tyre, ka rezultuar se prindërit e subjektit të rivlerësimit kanë pasur të ardhura të mjaftueshme nga burime të ligjshme për të justifikuar pasuritë e tyre.

9.1 Komisioni, gjatë hetimit administrativ të kryer për subjektin e rivlerësimit, ka hetuar edhe për personat e lidhur, prindërit e subjektit, pasuritë e tyre, të ardhurat e deklaruara ndër vite dhe fitimin e realizuar.

9.2 Nga hetimi nuk kanë rezultuar të dhëna apo *indicie* për pasuri të tjera të subjektit të rivlerësimit apo personave të lidhur me të, të padeklaruara prej saj.

#### Konkluzione për rubrikën e vlerësimit të pasurisë

19. Nga hetimi rezultoi se bilanci financiar sipas këshillimit të Njesisë së Shërbimit Ligjor është pozitiv – as subjekti i rivlerësimit dhe as prindërit e saj nuk kanë rezultuar me probleme lidhur me pasurinë dhe analizën financiare ndër vite.

Nga hetimi i kryer dhe vlerësimi i dokumenteve të administruara në dosje, trupi gjykues arriti në përfundimin se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

## B. KONTROLLI I FIGURËS

20. Drejtorja e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit dhe ka dërguar raportin mbi kontrollin e figurës në datën 2.11.2017, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016. Raporti, në përfundim, konstaton përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, znj. Elona Mihali. Ky raport është përgatitur pa përgjigjen e njërit prej organeve verifikuese. Në vijim, në datën 23.1.2018 është dërguar nga DSIK-ja informacioni plotësues.

20.1 Komisioni ka kërkuar përditësim të informacionit lidhur me subjektin e rivlerësimit, znj. Elona Mihali, dhe në përgjigjen e dërguar nga DSIK-ja në datën 28.9.2020 nuk kanë rezultuar të dhëna apo *indicie* për hetime të mëtejshme për subjektin e rivlerësimit.

20.2 Në vijim, Komisioni i ka kërkuar DSIK-së deklasifikimin e raportit të vlerësimit për këtë subjekt, të cilin ajo e ka deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. \*\*\*, datë 9.12.2020, të KDZH-së.

21. Gjatë procesit të hetimit administrativ Komisioni nuk konstatoi asnjë problematikë lidhur me pastërtinë e figurës për subjektin e rivlerësimit, znj. Elona Mihali.

#### Konkluzione për rubrikën e vlerësimit të figurës

22. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi dokumentacionin e dorëzuar prej subjektit të rivlerësimit, deklaratën për kontrollin e figurës, raportin e DSIK-së dhe informacionet nga organet ligjzbatuese, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar formularin e deklarimit

për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi. Nuk u provua që subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo që të jetë e përfshirë, apo e vënë nën presion nga persona të përfshirë në krimin e organizuar, si rrjedhojë, e gjen atë të përshtatshme për vazhdimin e detyrës.

Në përfundim, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Elona Mihali, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

### **C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE**

**23.** Këshilli i Lartë Gjyqësor, si organi ndihmës për vlerësimin profesional, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” ka dorëzuar raportin profesional.

**23.1** Në analizë të përbashkët të dokumenteve të vlerësuara, konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka nivel në arsyetimin e vendimeve ligjore të vëzhguara dhe respekton standardin e procesit të rregullt ligjor. Nuk është identifikuar asnjë rast nga dokumentet ligjore dhe dosjet e vëzhguara, që të jetë cenuar nga Gjykata e Apelit ose Gjykata e Lartë, për shkak të procesit të rregullt ligjor në aspektin e arsyetimit të vendimit gjyqësor. Ajo i kushton rëndësinë e duhur arsyetimit të vendimeve të ndërmjetme, ku në të gjitha rastet pasqyrohet saktë shkaku dhe baza ligjore.

**23.2** Znj. Elona Mihali ka njohuri të mira në të drejtën materiale dhe atë procedurale civile dhe konkretisht, lidhur me pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv dhe kundërshtimin e veprimeve përmbarimore, detyrimin për pagim shume (shihni dokumentet 2 dhe 3), me goditjen e pavërtetësisë së dokumentit, si dhe lidhur me të drejtën familjare, konkretisht për zgjidhjen e martesës (shihni dosjet 1 dhe 2), pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv, faturave të energjisë elektrike, si dhe të drejtën e punës, konkretisht dëmshpërblimin nga marrëdhëniet e punës (shihni dosjet 3 dhe 4).

**23.3** Në pesë dosjet gjyqësore të vëzhguara në procesverbalin gjyqësor është konstatuar se gjyqtarja Elona Mihali komunikon me etikë me palët ndërgjyqëse në gjykim. Ajo ka aftësi komunikuese me palët ndërgjyqëse, si gjatë veprimtarisë përgatitore dhe asaj gjyqësore, ku shfaq sjellje etike, duke ruajtur paanësinë në gjykim dhe respektuar barazinë e palëve.

**24.** Gjatë periudhës së rivlerësimit, për gjyqtaren Elona Mihali, janë paraqitur në Inspektoratin e KLD-së 4 ankesa për zvarritje në gjykim, 3 prej të cilave, pas verifikimit, janë evidentuar për efekt vlerësimi profesional dhe etik, ndërsa për 1 ankesë relacioni përfundimtar nuk është mbyllur nga inspektori përgjegjës dhe me anë të procesverbalit nr. \*\*\* prot., datë 28.7.2020, ankesa i ka kaluar Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (shihni të dhënat nga burimet arkivore të KLD-së).

**25.** Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, për gjyqtaren Elona Mihali përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

### **Konkluzione për rubrikën e vlerësimit profesional**

**26.** Trupi gjykues vlerëson se në bazë të të gjitha rrethanave dhe kushteve të mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të mira në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve dhe konsiderohet “e aftë”.

Trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka nivelin minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas kërkesave të nenit 58 pika 1 gërma c të ligjit nr.84/2016.

## DENONCIMET E PUBLIKUT

27. Në Komision janë paraqitur 13 denoncime, 8 prej tyre i drejtohen subjektit të rivlerësimit si gjyqtare e vetme, të tjerët i drejtohen trupit gjykues ose një grupi gjyqtarësh.

28. Në një rast denoncuesit kanë bërë edhe kallëzim penal për subjektin e rivlerësimit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fierit, e cila pas shqyrtimit ka vendosur mosfillimin e saj.

29. Gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioni është vënë në dijeni mbi disa të dhëna në formë denoncimi të marra në portalet mediatike <https://www.gazeta-shqip.com/në-fokus/skandalimi-më-i-madh-i-pronave-në-dhërmi-gjyqtarja-elona-mihali-i-dha-fal-3759> dhe pas shqyrtimit rezultoi se kjo çështje është pjesë e njërit prej denoncimeve të ardhura në Komision.

30. Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit shpjegime të detajuara dhe dokumentacion provues lidhur me pretendimet e denoncuesve në të gjitha denoncimet e ardhura.

31. Në vijim të rezultateve të hetimit, subjekti ka shpjeguar: *“Në lidhje me denoncimet nga publiku më kërkohet dhënia e shpjegimeve dhe argumenteve në lidhje me to. Konstatohet se denoncimet me shkrim nga publiku lidhen vetëm me 9 (nëntë) çështje, pasi rezultoi se të njëjtët subjekte kanë paraqitur disa herë denoncime në lidhje me të njëjtën çështje. Në vijim po parashtrij shpjegime dhe argumente për çdo rast.*

**a) Në lidhje me denoncimin nr. \*\*\* prot., datës 22.11.2017, z. R. M.**

*Konstatohet se problematikat që vendos në dukje denoncuesi në denoncim lidhen me vlerësimin në themel të çështjes. Gjykata vlerëson çështjen bazuar në bindjen e brendshme të krijuar nga vlerësimi në tërësi i provave të paraqitura në gjykim në zbatim të nenit 29 të Kodit të Procedurës Civile: “Gjykata mbështet vendimin në provat e paraqitura nga palët ose nga prokurori, të marra në seancë gjyqësore. Gjykata çmon provat që ndodhen në aktet, në bazë të bindjes së saj të brendshme, të formuar nga shqyrtimi në tërësinë e tyre të rrethanave të çështjes”. Konstatohet se në rastin konkret ky vlerësim i gjykatës është pasqyruar në mënyrë të detajuar në përmbajtjen e vendimit gjyqësor nr. \*\*\* akti, datë 7.12.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, të cilin po e paraqes.*

**b) Në lidhje me dy denoncimet nr. \*\*\* prot., datë 27.4.2018 dhe nr. \*\*\* prot., datë 10.5.2018, të shtetases N. A.**

*E njëjta shtetase ka paraqitur dy denoncime, të cilat lidhen me të njëjtën çështje nr. \*\*\* regj. them., konkretisht në lidhje me disponimin me vendimin e datës 25.7.2016, për sigurimin e padisë, të cilin po e paraqes si provë. Vlerësoj se pretendimet e denoncueses nuk qëndrojnë.*

*Denoncuesja pretendon se vendimi për sigurimin e padisë është haptazi i paligjshëm dhe për këtë i referon se gjykata nuk ka analizuar faktin nëse paditësi gëzon ose jo legjitimitet material.*

***Kjo çështje është gjykuar në gjykatën më të lartë, e cila ka ndryshuar vendimin por nuk ka vendosur ta prishë atë, pra gjykata e apelit (shumica) ka vlerësuar ndryshe për sigurimin ose jo të padisë, por Gjykata e Apelit nuk ka konstatuar gabime në procedurë apo shkelje procedurale në shqyrtimin e kërkesës në shkallë të parë.***

**c) Në lidhje me denoncimin nr. \*\*\* prot., të datës 30.11.2017, z. A. A.**

*Konstatohet se problematikat që vendos në dukje denoncuesi në denoncim lidhen me vlerësimin në themel të çështjes, vlerësim i cili përbën bindjen e brendshme të gjyqtarit të krijuar nga vlerësimi në tërësi i provave të paraqitura në gjykim në zbatim të nenit 29 të Kodit të Procedurës Civile. Ky vlerësim i gjykatës është pasqyruar në mënyrë të detajuar në përmbajtjen e Vendimit gjyqësor nr. \*\*\*, datë 3.11.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, të cilin po e paraqes. Vlerësoj se analiza e provave në vendimin që kam disponuar nr.*

\*\*\*, datë 3.11.2017 është e plotë dhe bindja e brendshme e krijuar nga shqyrtimi në tërësi i provave është pasqyruar në vendim në mënyrë të detajuar.

**ç) Në lidhje me denoncimin nr. \*\*\* prot., të datës 20.3.2018, z. G. T.**

Denoncimi lidhet me çështjen për të cilën kam disponuar vendimin nr. \*\*\*, datë 18.3.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, të cilin po e paraqes. Në këtë vendimmarrje kam qenë kryesuese e trupës gjyqësore dhe kam arsyetuar vendimin. Gjykata ka disponuar për rrëzimin e padisë me paditës Federata \*\*\* të Shqipërisë kundër Ministrisë së Brendshme me objekt të padisë 'pagimi i të ardhurave për përdorim të sendit të paluajtshëm'.

Pretendimet e denoncuesit lidhen edhe me çështje tjetër që kam pasur për shqyrtim me kërkues G. T. me objekt përjashtimi trupi gjyqësor, konkretisht **Vendimi nr. \*\*\*, datë 15.2.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, të cilin po e paraqes.** Denoncuesi nuk është dakord me vlerësimin kërkesës nga gjykata dhe vlerëson se nuk është i bazuar në normat ligjore.

Vlerësoj se vendimi është i mbështetur në dispozitat ligjore procedurale dhe nëse denoncuesi nuk ka qenë dakord me vlerësimin e gjykatës ka pasur të drejtën të ushtronte rekurs në Gjykatën e Lartë brenda 10 ditëve.

Këto pretendime të sipërcituara të denoncuesit dhe denoncimi që ai ka bërë ndaj disa gjyqtarëve janë trajtuar nga Inspektorati i Lartë i Drejtësisë, i cili ka disponuar për arkivimin e disa ankesave të paraqitura në kohë të ndryshme të z. G. T., Sekretarit të Përgjithshëm të \*\*\* Patos, Organizata \*\*\*, ndaj të njëjtëve gjyqtarë, ku parashtrihen të njëjtat pretendime, të cilat janë bashkuar për efekte shqyrtimi dhe trajtimi të përbashkët. **Ky vendim i ILD-së për arkivimin e ankesës u është njoftuar gjyqtarëve, me aktin me lëndë 'Njoftim mbi vendimin e arkivimit të ankesave pas shqyrtimit fillestar' nr. \*\*\* prot., datë 22.12.2020 dhe po e paraqes si provë.**

**d) Në lidhje me çështjen me palë K. V. kundër ATP-së për të cilën pala ka bërë kallëzimin penal të mosfilluar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier**

Denoncimi lidhet me procesin gjyqësor të përfunduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 24.2.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

**Kohëzgjatja e gjykimit.** Nga verifikimi në sistemin ICMIS të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë rezulton se çështja më është caktuar për gjykim me shortin e datës 16.1.2020 (rishortim) dhe ka përfunduar me vendim në datën 24.2.2020, pra, gjithsej 1 muaj dhe 8 ditë.

Çështja më ka kaluar për shqyrtim pas rishortimit të datës 16.1.2020 dhe ndryshimit të trupës gjyqësore dhe, në këto raste, veprimet procedurale në lidhje me çështjen fillojnë të realizohen nga e para dhe veprimet e trupës gjyqësore të mëparshme humbasin efektet, në rast se trupa gjyqësore e re vlerëson se **veprimet procedurale të trupës gjyqësore të mëparshme nuk kanë qenë të plota dhe, për më tepër, nëse konstatohet se padia ka pasur të meta që në fillim të shqyrtimit të saj nga trupa e mëparshme dhe këto të meta nuk janë plotësuar as në vijimësi.**

Pretendimet e tjera të denoncuesit lidhen më **përmbajtjen e vendimit për konstatimin e të metave të padisë**, pretendime të cilat lidhen me vlerësimin e provave apo mangësive në to, që gjykata ka për detyrë të konstatojë menjëherë me regjistrimin e çështjes sipas neneve 154, 154/a dhe 156 të Kodit të Procedurës Civile të ndryshuar dhe pasi studion dosjen. Vlerësoj se vendimi për konstatimin e të metave të padisë është i detajuar, është i qartë dhe referon në bazën ligjore në të cilën janë konstatuar të metat e padisë.

Pala paditëse e përfaqësuar, pasi u njoh me vendimin për konstatimin e të metave të padisë datë 27.1.2020 kishte paraqitur ndaj trupës gjyqësore kallëzim penal pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë në datën 10.2.2020, për dijeni Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit dhe Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë dhe për dijeni edhe trupës gjyqësore.

*Pala paditëse e përfaqësuar paraqiti njëkohësisht edhe kërkesë për përjashtimin e trupës gjykuese, kërkesë e cila u shqyrtua me Vendimin nr. \*\*\*, datë 12.2.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor nga tjetër trup gjykues, e cila ka vendosur për “**Rrëzimin e kërkesës**”.*

*Nisur nga pretendimet e parashtruara nga pala kërkuese si në kërkesën për përjashtimin e trupës gjykuese, ashtu edhe nga fakti se ndaj trupës gjykuese është paraqitur kallëzim penal në lidhje me vendimmarrjen e ndërmjetme të datës 27.1.2020, nga ana ime si trup gjykues, pasi u njoha edhe me vendimin nr. \*\*\*, datë 12.2.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë për rrëzimin e kërkesës për përjashtimin tim, si dhe për të shmangur çdolloj perceptimi të padrejtë mbi paanësinë dhe trajtimin objektiv të çështjes, në datën 14.2.2020 u paraqit Kërkesë për Heqjen Dorë nga gjykimi i çështjes, kërkesë e cila me Vendimin e datës 18.2.2020, të Kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë nuk u pranua.*

*Ndodhur në kushtet kur si kërkesa për përjashtim trupi gjykues, ashtu edhe kërkesa e vetë trupës gjykuese për heqjen dorë nga gjykimi i çështjes pas rënies në dijeni të realizimit të kallëzimit penal, u rrëzuan, vijova me shqyrtimin e çështjes.*

*Asnjë nga të metat e padisë nuk u plotësua brenda afatit të caktuar, duke passjellë kështu kthimin e padisë.*

**dh) Në lidhje me denoncimin nr. \*\*\* prot., datë 6.8.2018, të z. H. S.**

*Denoncimi lidhet me çështjen me nr. \*\*\* akti, datë vendimi 13.11.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, vendim të cilin po e paraqes. Denoncuesi ka pretendime në lidhje me vlerësimin që gjykata ka bërë me vendimin nr. \*\*\* akti, datë 13.11.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Vendimmarrja është plotësisht e argumentuar dhe ka referimet përkatëse ligjore në legjislacionin në fuqi dhe ato të jurisprudencës gjyqësore në kohën në të cilën është disponuar vendimi, konkretisht Vendimi nr. \*\*\*, datë 19.12.2016, i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë. Analiza e kompetencës funksionale në lidhje me paditë me objekt kundërshtimin e vendimeve të KKKP-së, është bazuar në dispozitat e reja ligjore të ligjit nr. 133/2015, ‘Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave’, si dhe në qëndrimin që Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë kishte mbajtur në lidhje me kompetencën funksionale për shqyrtimin e këtyre padive.*

*I njëjti vlerësim me atë që kam mbajtur në këtë vendim është aplikuar në gjerësi në të gjitha paditë me objekt kundërshtimin e vendimeve të AKKP-së, ish-ZRKPP-së, KKKP-së etj. në vitin 2017 ku ende nuk kishte një vendim të Gjykatës së Lartë që të njehsonte praktikën gjyqësore në lidhje me ushtrimin e padive sipas ligjit nr. 133/2015. Po paraqes vendime të tjera të disponuara ku është vlerësuar se kompetenca funksionale për shqyrtimin e padive me objekt kundërshtimin e ish-AKKP-së, ish-KKKP-së i përket Gjykatës së Apelit, sikurse vendimi nr. \*\*\*, datë 18.9.2017 dhe nr. \*\*\*, datë 5.10.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Kjo praktikë është zbatuar gjerësisht si nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë edhe në Gjykata të tjera.*

**e) Në lidhje me denoncimin nr. \*\*\* prot., datë 27.11.2018, të z. M. M.**

*Denoncimi lidhet me çështjen e përfunduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 29.10.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, të cilin po e paraqes. Denoncuesja pretendon se gjykata ka vendosur në disfavorin e saj, por ky pretendim lidhet me faktin se denoncuesja nuk është dakord me zgjidhjen e çështjes.*

**ë) Në lidhje me denoncimin nr. \*\*\*, datë 15.1.2020, të z. G. I., avokat**

*Denoncimi lidhet me çështjen për të cilën është disponuar vendimi nr. \*\*\*, datë 14.11.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, të cilin e po e paraqes. Denoncuesi parashtron pretendime se paditësave nuk i është siguruar e drejta për të qenë të përfaqësuar në gjykim. Në fakt që në seancën e parë datë 3.10.2019 paditësat kanë qenë të përfaqësuar nga avokat tjetër nga ai që paraqet denoncimin, avokat i cili kishte tagra përfaqësimi të fituara nga av. G. I. Që në*



seancën e parë hetimi është mbyllur dhe palëve u është dhënë kohë për të paraqitur pretendimet përfundimtare.

Në lidhje me pretendimet mbi vlerësimin e çështjes në themel nga Gjykata me vendimin që kam disponuar nr. \*\*\*, datë 14.11.2019 vlerësoj se këto janë aspekte që vlerësohen në kuadër të apelimit të vendimit. Pavarësisht këtij pretendimi të denoncuesit vendimi është i arsyetuar, çdo kërkim i kërkuësve ka gjetur vlerësimin përkatës ligjor në bazë të provave që janë paraqitur.

f) Në lidhje me: denoncimin nr. \*\*\* prot., datë 28.5.2019, të Micro Credit Albania sh. a.; tre denoncimet nga subjekti F. K.; denoncimin nr. \*\*\*, datë 13.9.2019, të D. D.

Konstatohet se denoncimet janë të pambështetura dhe nuk plotësojnë kushtet e nenit 53/2 të Ligjit nr. 84/2016, në referim të nenit 72/4 të Ligjit nr. 96/2016. Pretendimet e denoncuesit i përkasin shqyrtimit të padisë nga gjykatat më të larta mbi bazë të ushtrimit të së drejtës së apelimit ose rekursit, pasi lidhen me vlerësimin në themel të çështjes.

g) Në lidhje me denoncimin e marrë nga media

Konstatohet se shkrimi paraqet rrethana të cilat nuk pasqyrojnë jo vetëm të vërtetën mbi vlerësimin e çështjes në themel, por paraqet një situatë shqyrtimi procedural krejt të ndryshme nga e vërteta. Si prova paraqes: Vendimin nr. \*\*\*, datë 4.12.2019, të Gjykatës së Apelit Vlorë; Vendimi nr. \*\*\*, datë 22.7.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; Vendimi nr. \*\*\*, datë 9.9.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; Vendimi nr. \*\*\*, datë 27.1.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Çështja është shqyrtuar nga trup gjykues i përbërë nga tre gjyqtarë. Subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë relator i çështjes, vendimi ka qenë unanim dhe ai është shkruar e arsyetuar nga relatori/kryesues i çështjes.

E vërteta e rastit është e kundërt dhe krejt e ndryshme nga shkrimi, i cili përveçse nuk është i vërtetë, rezulton të jetë dukshëm tendencioz, pasi të gjitha rrethanat e pavërteta ia atribuon një gjyqtari të vetëm, duke e vendosur në titull dhe me foto. Është i pavërtetë pasi po kjo media T. C. dhe gazeta e saj Sh. e ka paraqitur edhe më parë këtë çështje në muajin Shtator 2020 dhe ka zbuluar, si dhe ka marrë të gjitha vendimet gjyqësore që janë disponuar nga Gjykata e Shkallës së Parë Vlorë dhe Gjykata e Apelit Vlorë, duke pasur informacion të plotë për ecurinë procedurale të shqyrtimit të kësaj çështjeje penale ndër vite me trupa të ndryshëm gjykues. Vetë kjo media, e cila ka bërë shkrimin në datën 24.11.2020 (dijeninë në lidhje me këtë shkrim po e marr nga pyetja që më bëhet nga KPK-ja), në datat 19 Shtator 2020 dhe në ditët në vijim po në Shtator 2020 në një kronikë të dytë ka evidentuar vendimin e Gjykatës së Apelit Vlorë nr. \*\*\*, datë 4.12.2019 me trup gjykues K. G., S. D. dhe H. S., si vendimi mbi të cilin është bazuar vendimi nr. \*\*\*, datë 22.7.2020, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë me trup gjykues H. S., H. Ç. dhe E. M.. Është pikërisht vendimi i Gjykatës së Apelit Vlorë nr. \*\*\*, datë 4.12.2019 ai i cili ka vendosur dhe ka vlerësuar se aktet të cilat ishin vlerësuar më parë me vendim gjyqësor të formës së prerë të falsifikuara nuk janë të falsifikuara. Bazuar në këtë vendim penal të formës së prerë, është vlerësuar nga trupi gjykues ku bëja pjesë edhe unë, nëse ekzistonin ose jo elementet e figurës së veprës penale 'Pastrimit të produkteve të veprës penale dhe të veprimtarisë kriminale' ndaj të pandehurve B..

Çështja penale që kam pasur në shqyrtim ka pasur si objekt të saj rishikimin e vendimit penal nr. \*\*\*, datë 4.10.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, lënë në fuqi me vendimin nr. \*\*\*, datë 22.11.2018, të Gjykatës së Apelit Vlorë bazuar në nenin 449 e vijues të Kodit të Procedurës Penale. Këto vendime penale lidheshin me procedimin penal ndaj P. B., Th. B. dhe Th. B., të akuzuar për veprën penale 'Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale', parashikuar nga neni 287 dhe të dënuar po për këtë veprë.

Dënimi i këtyre tre shtetasve ishte bazuar në përfundimet e arritura në një tjetër procedim penal të përfunduar me vendim gjyqësor të formës së prerë që ka pasur si objekt të tij veprën penale mëmë, e cila ka qenë 'Falsifikimi i dokumenteve në bashkëpunim nga personi që ka për detyrë të lëshojë dokumentin', parashikuar nga nenet 186/3 e 25 të Kodit Penal konsumuar nga shtetasit J. B. dhe A. LL. Dënimi i këtyre dy shtetasve ishte bërë me vendimin nr. \*\*\*, datë 18.10.2012, të Gjykatës së Apelit Vlorë.

Gjykata e Apelit Vlorë, me Vendimin nr. \*\*\*, datë 4.12.2019, ka realizuar rishikimin e vendimit nr. \*\*\*, datë 18.10.2012, të formës së prerë për dënimin e J. B. dhe A. LL. dhe në përfundim ka vendosur për pafajësinë e këtyre shtetasve. Gjykata e Apelit Vlorë ka vlerësuar po ashtu se nga provat e administruara, arrihet në përfundimin e padiskutueshëm se provohet jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se dokumenti me nr. \*\*\*, datë 31.1.2003, i Këshillit të Bashkisë Himarë, nuk është i falsifikuar. Në këto kushte Gjykata e Apelit ka lënë në fuqi vendimin me nr. \*\*\*, datë 13.12.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, duke shpallur të pafajshëm shtetasit J. B. dhe A. LL.

Është pikërisht ky vendim i Gjykatës së Apelit nr. \*\*\*, datë 4.12.2019, i cili është bazuar në shkresën me nr. \*\*\* prot., datë 17.6.2019, lëshuar nga Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës Bashkia Himarë dhe vënë në dispozicion nga mbrojtësit të pandehurve J. B. dhe A. LL., në të cilin Gjykata e Apelit ka konkluduar tashmë në të kundërtën e asaj që ishte përcaktuar vite më parë me formë të prerë, pikërisht se vendimi me nr. \*\*\*, datë 31.1.2003, i Këshillit të Bashkisë Himarë, akt për të cilin më parë ishin deklaruar fajtor dhe dënuar shtetasit J. B. dhe A. LL. nuk është i falsifikuar. Procedura e rishikimit të vendimit në apel është lejuar me vendimin nr. \*\*\*, datë 9.9.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Në përfundim, vlerësohet se denoncimi i konstatuar në media është i pambështetur dhe nuk plotëson kushtet e nenit 53/2 të Ligjit nr. 84/2016 në referim të nenit 72/4 të Ligjit nr. 96/2016 dhe informacioni i dhënë nga media në lidhje me subjektin tim është i pavërtetë.”

32. Pas vlerësimit të shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit në raport edhe me dokumentacionin mbi denoncimet nga trupi gjykues nuk u vërejtën rrethana për fakte që krijojnë bindjen se ka pasur shkelje ligjore, apo të dhëna dhe *indicie* për subjektin e rivlerësimit, të cilat mund të merren në konsideratë në vlerësimin e saj profesional, në kuadër të procesit të rivlerësimit.

## PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në germën “a”, të pikës 1, të nenit 58 dhe pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi konstatoi se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, si dhe një nivel të mirë të vlerësimit të aftësive profesionale,

## V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Elona Mihali, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë.
2. Ky vendim, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga Komisioneri Publik dhe/ose nga subjekti i rivlerësimit, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.

4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, në datën 18.1.2021.

**ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Brunilda BEKTESHI**

**Kryesuese**

**Valbona SANXHAKTARI**

**Relatore**

**Genta TAFA (BUNGO)**

**Anëtare**

*Elda Faruku*

*Sekretare gjyqësore*